

# MANUAL I ISLAMIT

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR NGA BURIME TË NDRYSHME RRETH  
NJOHURIVE THEMELORE TË FESË ISLAME



<b>PARATHËNIE</b> .....	<b>4</b>
<b>TRI NJOHJET THEMELORE</b> .....	<b>5</b>
KRIJUESI YT.....	5
I DËRGUARI YT .....	7
FEJA JOTE.....	10
<b>QËLLIMI I KRIJIMIT</b> .....	<b>14</b>
<b>SHIRKU</b> .....	<b>17</b>
BESËTYTNITË.....	23
SHEMBUJ NGA BESËTYTNITË .....	25
<b>ISLAMI DHE IMANI (BESIMI)</b> .....	<b>28</b>
KUSHTET (SHTYLLAT) E ISLAMIT .....	29
<i>Shtylla e parë: Dy dëshmitë (shehadeti)</i> .....	29
<i>Shtylla e dytë: Namazi</i> .....	34
<i>Shtylla e tretë: Zekati (lëmosha e obligueshme)</i> .....	35
<i>Shtylla e katërt: Agjërimi i ramazanit</i> .....	37
<i>Shtylla e pestë: Haxhi</i> .....	38
KUSHTET E IMANIT (BESIMIT) .....	40
<i>Kushti i parë: Besimi në Allahun</i> .....	40
<i>Kushti i dytë: Besimi në engjëjt</i> .....	41
<i>Kushti i tretë: Besimi në Librat</i> .....	44
<i>Kushti i katërt: Besimi në të Dërguarit dhe Lajmëtarët (pejgamberët)</i> .....	48
<i>Kushti i pestë: Besimi në Ditën e Fundit</i> .....	51
<i>Kushti i gjashtë: Besimi në Kader (paracaktim hyjnor)</i> .....	53
<b>XHENETI – SHPËRBLIMI PËR TË QENËT ROB I MIRË</b> .....	<b>57</b>
<b>XHEHENEMI – NDËSHKIMI PËR MOSNËNSHTRIM</b> .....	<b>61</b>
<b>NAMAZI DHE PARAPËRGATITJET PËR TË</b> .....	<b>65</b>
ABDESI – PASTRIMI PËR NAMAZ .....	65
GUSLI – PASTRIMI I PLOTË I TRUPIT .....	69
TEJEMUMI – PASTRIMI ME DHË .....	71
FALJA E NAMAZIT .....	72
<i>Disa etiketa të namazit</i> .....	82
<i>Namazi për të vdekurin (xhenazen)</i> .....	83
<i>Kaptina të shkurtra të Kuranit</i> .....	85
REFERENCA.....	88

## PARATHËNIE

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve, dhe paqja e shpëtimi qofshin mbi zotërinë e peygamberëve, Muhamedin صلى الله عليه وسلم, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij.

Ky është një cikël edukativ lidhur me fenë tënde, Islamin, nëpërmjet të cilit do të mësosh më të rëndësishmen me të cilën të obligoi Krijuesi yt madhështor, Allahu. Gjithashtu, do të njihesh me jetën dhe traditën e peygamberit tënd fisnik, Muhamedin صلى الله عليه وسلم, si dhe me gjërat themelore të besimit.

Vlera e këtij cikli qëndron në karakterin përfshirës të tij, kualitetin e lartë të përmbajtjes dhe lehtësinë e metodës e cila të mundëson një kuptim të kollajshëm, pa pasur nevojë për ndihmën e dikujt tjetër, përveç në raste të rralla. E lusim Allahun që të kesh dobi nga kjo. Vërtet, Ai dëgjon dhe përgjigjet.

## TRI NJOHJET THEMELORE

### KRIJUESI YT

Dije se njohja e Allahut, besimi në Të, adhurimi ndaj Tij dhe vërtetimi i gjithë asaj që vjen nga Ai janë nga gjërat më të rëndësishme të cilat muslimani është i obliguar t'i mësojë, t'i njohë dhe t'i kuptojë. Kush nuk e njeh Allahun, Krijuesin, Sunduesin dhe Udhëheqësin e vet, ai, në të vërtetë, e jeton jetën e kësaj bote si kafsha: ha, pi, fle e zgjohet, derisa të përfundojë jeta e tij në këtë gjendje e të mos dijë për çka u krijua dhe pse jeton. Allahu i lartësuar thotë:

" ... e ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë siç hanë kafshët. Vendi i tyre është Zjarri."<sup>1</sup>

Çdo njeri ka mendje, e detyrë e mendjes është të logjikojë. Kur kjo detyrë nuk kryhet, funksioni i mendjes zhvlerësohet dhe kështu dështon puna kryesore e saj. Pikërisht kjo bëhet shkak që njeriu të largohet nga e mira dhe t'i afrohet të keqes. Allahu në Kuranin fisnik na thërret të logjikojmë për atë çfarë jemi, ku thotë:

"Thuaj: 'A është i barabartë i verbri me atë që sheh?' A nuk mendoni?"<sup>2</sup>

"A nuk menduan thellë ata (në veten e tyre)...?"<sup>3</sup>

Gjithashtu, i Madhëruari na fton të shikojmë në krijimin e qiellit, tokës, vetëve tona dhe në të gjitha krijesat; na thërret të logjikojmë për krijimin e kësaj gjithësie të gjerë, e cila e tëra është krijimtari e Allahut të patëmeta.

---

<sup>1</sup> Muhamed, 12.

<sup>2</sup> el-En'am, 50.

<sup>3</sup> Er-Rrum, 8.

Pasi që të logjikojë dhe të meditojë, njeriu do të nxjerrë përfundimin se kjo gjithësi e gjerë dhe e madhe ka një Krijues madhështor, një Sajues të Urtë, që është Allahu, Zoti jonë. Allahu cilësohet me cilësi të përsosura me të cilat Ai e përshkruan qenien e Tij madhështore në Kuranin fisnik dhe me të cilat e përshkroi krijesa më e ditur për Të, i Dërguari i fundit, Muhamedi صلى الله عليه وسلم. Prej këtyre cilësive janë: mëshira, krenaria, falja e poshtërimi (që Ai u bën të tjerëve), si dhe shumë cilësi tjera të cilat gjenden në Kuranin Fisnik dhe në hadithet (thëniet) e pejgamberit صلى الله عليه وسلم. Qëllimi kryesor në njohjen e këtyre cilësive është që të ndalemi para dobësisë sonë dhe nevojës që kemi për këtë Hyjni madhështore, që është larg çdo të mete dhe mangësie.

Allahu na e tregon qëllimin për të cilin i krijoi të gjitha krijesat. Allahu i madhëruar thotë:

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë."<sup>4</sup>

Prandaj, adhurimi (ibadeti) është qëllim të cilin duhet ta kryejmë me përpikëri duke iu nënshtruar Allahut të madhëruar dhe duke e falënderuar për atë që na ka dhënë prej begative dhe dhuntive të shumta. Allahu i lartësuar thotë:

"Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë (të mirat) e Allahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktoni ato."<sup>5</sup>

Pasi të na bëhet e qartë kjo, obligohemi që ta adhurojmë Allahun me adhurim të vërtetë dhe që ky adhurim të jetë vetëm për Të, pa i shoqëruar askënd Atij; t'i lutemi vetëm Atij, t'ia kemi frikën vetëm Atij, të kërkojmë ndihmë vetëm prej Tij, dhe të gjitha llojet e ibadetit të jenë vetëm për këtë Hyjni madhështore, që është

<sup>4</sup> edh-Dharijatë, 56.

<sup>5</sup> en-Nahl, 18.

Krijues, Furnizues, i Fuqishëm; i cilësuar me cilësitë më të larta dhe më madhështoret.

## I DËRGUARI YT

Për të na njoftuar për atë çka Ai kërkon prej nesh dhe për të na sqaruar atë çka na bënë dobi në jetën tonë, Allahu dërgoi prej njerëzve disa që kishin cilësi fisnike dhe moral të lartë për t'ua përcjellë urdhrat dhe dispozitat e Tij të gjithë njerëzimit, duke filluar prej të afërmve, shokëve, fqinjëve dhe të gjithë të tjerëve përreth atyre të Dërguarve.

I fundit prej këtyre të Dërguarve dhe Lajmëtarëve (pejgamberëve) ishte i Dërguari i Allahut dhe prijësi ynë, Muhamedi صلى الله عليه وسلم, të cilin Allahu e dërgoi si mëshirë për të gjitha botët, të njerëzve e të xhinëve.

"Dhe Ne nuk të dërguam ty (Muhamed) ndryshe veçse si mëshirë për të gjitha botët."<sup>6</sup>

Për ta pasur edhe më të qartë këtë që përmendëm, domosdo, duhet të dimë pjesë nga jeta e këtij pejgamberi fisnik.

Emri i tij është Muhamed ibn Abdullah ibn Abdul-Mutalib ibn Hisham. Ai rrjedh nga fisi më i madh i fiseve arabe, fisi Kurejsh. Ai u lind në Mekë, në Gadishullin Arabik, një prej qyteteve të Mbretërisë së sotme Saudite. Ai u rrit jetim, pasi babai i vdiq ndërsa ishte në barkun e nënës. Atë e edukoi nëna e tij, Amineja, bija e Vehbit, me një edukatë që përkonte me traditat arabe, shumicën nga të cilat i trashëguan nga feja e babait të pejgamberëve, Ibrahimit (alejhi selam). Nëna i vdiq kur ai ishte 6 vjeçar dhe kujdesin për të e vazhdoi gjyshi i tij Abdul-Mutalibi, i cili, para Shpalljes, ishte njëri prej udhëheqësve Kurejshit. Pas dy viteve, i vdiq edhe gjyshi, dhe përkujdesjen ndaj tij e mori mixha i

---

<sup>6</sup> el-Enbija, 107.

tij, Ebu Talibi. Jeta e tij, pas fëmijërisë, ishte jetë e dalluar me çdo të mirë. Ai ishte trim, i sinqertë, me moral të mirë, saqë edhe populli i tij filluan ta quanin i sinqerti, besniku.

Në fëmijëri, ai ishte bari i deleve, gjë që ia shtoi edhe më tepër dëlirësinë e zemrës, udhëzimin për të mirë dhe largimin nga e keqja. Gjatë rinisë së tij, punonte për Hadixhen, bijën e Huvejlidit, e cila ishte prej grave më të pasura dhe më të dalluara Kurejshite. Kur ai mbushi 25 vjet, mixha i tij e martoi me Hadixhen, e cila ishte 15 vjet më e vjetër se ai.

Kur i mbushi 40 vjet, Allahu e përgatiti për pejgamberllëk. Ai filloi të shihte ëndrra të vërteta, dhe gjithë ajo që shihte në ëndërr, të nesërmen i realizohej. Pastaj atij iu bë e dashur vetmia që të mund të reflektonte për aktin e krijimit, kështu që ai e kalonte një muaj të plotë të çdo viti në një shpellë afër Mekës, të quajtur Hira.

Pas një periudhe të shkurtër kohore, Allahu ia dërgoi njërin prej engjëjve të mëdhenj, engjëllin e quajtur Xhibril, i cili ia shpalli ajetin e parë:

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)."<sup>7</sup>

Nga kjo ai e kuptoi se Allahu e kishte zgjedhur të ishte pejgamber dhe i Dërguar i Tij te ai popull. Muhamedi ﷺ thërriste për adhurimin e të vetmit Allah dhe për thyerjen e idhujve, gjë që ishte në kundërshtim me fenë e gjyshërve dhe baballarëve të tyre. Për këtë shkak, ata filluan të bënin çmos që ta pengonin dhe ta tallnin atë vetëm e vetëm që të pengonin nga thirrja që bënte, por ai duroi përkundër gjithë asaj. Nga torturat dhe maltretimet e Kurejshitëve e mbronte mixha i tij, Ebu Talibi, i cili, megjithëkëtë, nuk e pranoi Islamin dhe vdiq si jobesimtar.

---

<sup>7</sup> el-Alek, 1.



Islami filloi të përhapej shumë aq shpejt, saqë atij iu bashkëngjitën edhe disa prej banorëve të Medines. Pasi ata u kthyen në vendin e tyre, Muhamedit صلى الله عليه وسلم i erdhën edhe një grup prej 12 vetash, të cilët, gjithashtu, ia shprehën besimin ndaj tij. Kur ata deshën të kthehen, Muhamedi صلى الله عليه وسلم ua dha me vete një shok të tijin, i cili do t'ua mësonte atyre parimet Islame. Pas pak kohe, Islami u përhap edhe në Medine dhe një grup prej banorëve të Medines i erdhën Muhamedit صلى الله عليه وسلم dhe e ftuan të shkonte tek ata duke iu besatuar atij se do ta mbronin dhe do ta ndihmonin.

Pejgamberi صلى الله عليه وسلم iu përgjigj ftesës së tyre dhe i urdhëroi shokët e tij që të dilnin nga Meka me qëllimin që t'u bashkëngjitej atyre më vonë. Posa u bë i ditur lajmi për shpërnguljen e Muhamedit صلى الله عليه وسلم, Kurejshitët dërguan disa njerëz që ta vritnin, por Allahu, si çdoherë, e shpëtoi nga ata.

Kur erdhi në Medine, e cila më vonë u quajt Medina e Ndritur, banorët e tij i bënë pritje madhështore. Menjëherë pas arritjes, ata e ndërtuan xhaminë e njohur si "Xhamia e pejgamberit صلى الله عليه وسلم" dhe filluan të thërrisnin në Islam dhe ta përhapnin atë haptazi. Kurejshitët bënë përpjekje të mëdha që ta pengonin thirrjen islame dhe përhapjen e saj, madje u munduan që këtë ta realizonin edhe me forcë. Ata përgatitën fuqi ushtarake që t'i mposhtnin muslimanët, por, megjithatë, Allahu u ndihmoi të dashurve të Tij (besimtarëve).

Beteja e parë mes Muhamedit صلى الله عليه وسلم dhe Kurejshitëve u zhvillua në Bedr, një vend në afërsi të Medinës, me çka dhe filluan betejat dhe përleshjet mes Muhamedit صلى الله عليه وسلم dhe jobesimtarëve. Ndodhën beteja e Uhudit, beteja e Hendekut, beteja e Hunejnit, e të tjera, dhe, pas çdo beteje, fuqia e Islamit shtohet edhe më tepër.

Për përhapjen e Islamit edhe më gjerë, Muhamedi dërgoi si misionarë disa shokë të tij te Kisrau, Kajseri, Nexhashiu e te mbretër tjerë prej mbretërive të mëdha, që t'i ftonin në fenë Islame.

Në vitin e nëntë të Hixhretit (migrimit nga Meka në Medine), muslimanët e çliruan Meken, e cila ishte dëshmitarja e parë e fillimit të misionit islamik, ndonëse banorët e saj e luftuan dhe u munduan ta pengonin atë. Atëherë, ajo konsiderohej si vendi më i madh në të cilin tuboheshin idhujtarët Kurejshit dhe të vendeve tjera.

Me çlirimin e Mekës, Muhamedit صلى الله عليه وسلم filluan t'i vinin delegacione të shumta.

Në vitin e dhjetë të Hixhretit, ai e kreu Haxhin lamtumirës dhe ua mbajti një ligjëratë të pranishmëve me porosinë e tij të fundit, që konsiderohet fjalimi më i gjatë që ai kishte ligjëruar ndonjëherë mbi çështjet dhe rregullat e fesë.

Me 12 rebiul-ewel të vitit dymbëdhjetë sipas Hixhretit, pas një sëmundje, i Dërguari i Zotit صلى الله عليه وسلم ndërroi jetë. Ai u varros në shtëpinë e tij, por sot varri i tij gjendet në brendësi të xhamisë së tij صلى الله عليه وسلم.

## FEJA JOTE

Pasi që Allahu i madhëruar e zgjodhi Muhamedin صلى الله عليه وسلم të jetë Vulë e peygamberëve (dmth i fundit), edhe feja në të cilën ishte ai, gjithashtu, është feja me të cilën Allahu është i kënaqur dhe njëherësh është Vulë e të gjitha feve. Allahu i lartësuar thotë:

"Feja e vetme e pranuar tek Allahu është Islami"<sup>8</sup>;

---

<sup>8</sup> Ali Imran, 19.

"Kush kërkon fe tjetër pos Islamit, ajo nuk do t'i pranohet dhe në botën tjetër do të jetë prej të dëshpëruarve."<sup>9</sup>

Me termin "Islam" nënkuptojmë nënshtrim, dorëzim; ndërsa me termin "musliman" nënkuptojmë atë që i është nënshtruar (dorëzuar) urdhrave të Allahut dhe i zbaton ligjet e Tij. Feja është praktikë jetësore e njeriut dhe metodologji e të menduarit të tij. Allahu është Krijuesi jonë dhe Ai e di realitetin tonë. Allahu i madhëruar thotë:

"... Ai e di të tashmen dhe të ardhmen e tyre. Të tjerët nuk dinë për ndonjë gjë, përveç aq sa Ai do..."<sup>10</sup>

Domethënë, meqë Allahu i madhëruar është Krijuesi, Ai është më i ditur për atë që është e mirë për ne dhe për atë që s'është e mirë për ne. Prandaj, feja jonë Islame është fe e cila përfshin çdo çështje jetësore; është fe e cila nderon njeriun dhe e ngritë në një shkallë të lartë. Allahu i lartësuar thotë:

" Ne, me të vërtetë, i nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit)"<sup>11</sup>;

" Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur."<sup>12</sup>

Njeriu në jetën e tij kalon nëpër periodën e provimit për t'u ditur se a do t'i nënshtrohet Zotit dhe a do t'i kryejë urdhrat e Tij. Allahu i lartësuar thotë:

"Gjithçka që është në tokë Ne e bëmë stoli të saj për t'i provuar ata se cili prej tyre do të jetë më mirëbërës."<sup>13</sup>

Kjo botë në të cilën ne jetojmë është vendi ku i kryejmë urdhrat e Allahut dhe largohemi nga ajo që Ai na ka ndaluar. Pas

---

<sup>9</sup> Ali Imran, 85.

<sup>10</sup> el-Bekare, 255.

<sup>11</sup> el-Isra, 70.

<sup>12</sup> et-Tinë, 4.

<sup>13</sup> el-Kehf, 7.

përfundimit të jetës sonë në këtë botë, vijon jeta në botën tjetër, prandaj ka prej atyre që do të shkojnë në Xhenet dhe ka prej atyre që do të shkojnë në Xhehenem. Kush i përgjigjet urdhrave të Allahut, largohet nga ajo që Ai ka ndaluar dhe i nënshtrohet Atij, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. Kush i kundërshton urdhrat e Allahut të lartësuar dhe nuk i nënshtrohet Atij, ai do të jetë prej banorëve të Zjarrit.

Feja jonë përfshin çdo aspekt jetësor. Ajo jo vetëm që nuk e lë anash këtë botë, por i kushton rëndësi të madhe. Në fe ka rregulla të cilat e përsosin jetën e kësaj bote. Allahu i lartësuar thotë:

"Dhe me atë që të ka dhënë Allahu kërko (ta fitosh) botën tjetër e mos lër mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë mirë Allahu ty e mos bëj të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit."<sup>14</sup>

Me veçoritë dhe specifikat që i ka, Islami ka bërë që shumë prej jobesimtarëve dhe idhujtarëve të hyjnë në të dhe t'i përmbahen rregullave të saja. Islami është fe e cila e ngritë njeriun në jetën e kësaj bote. Përderisa iu përmbajtën fesë së tyre, muslimanët ishin populli (bashkësia) më kualitativ, më i ngritur dhe më i lumtur. Sa e sa njerëz, gjatë shekujve dhe viteve të shumta, shijuan lumturinë dhe kënaqësinë me të, e sa e sa të tjerë u dëshpëruan dhe dështuan me kundërshtimin dhe moskryerjen e urdhrave dhe rregullave të saja.

Kjo është fe e plotë dhe rrugë e përsosur. Nuk ka mundësi askush, sado që ai të ketë dituri dhe njohuri, të gjejë mangësi në këtë fe madhështore, ngase Allahu e plotësoi dhe e përsosi. Në lidhje me këtë, Allahu i Gjithëmëshirshëm thotë në Librin e Tij fisnik:

---

<sup>14</sup> el-Kasas, 77.

"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe jam i kënaqur që Islami të jetë fe juaja."<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Maide, 3.

## QËLLIMI I KRIJIMIT

Pasi mësuam se në këtë botë nuk gjendemi kot dhe Krijuesi ynë është Allahu, i Cili e dërgoi pejgamberin Muhamed ﷺ te të gjitha krijesat për t'i thirrur në fenë Islame, na bëhet e qartë se është e obligueshme ta adhurojmë këtë Krijues madhështor ashtu siç do Ai, në mënyrë që me këtë ta fitojmë Xhenetin dhe të shpëtojmë nga Zjarri.

Adhurim (ibadet) është nënshtrimi ndaj urdhrave të Allahut, zbatimi i asaj me të cilën Ai na obligoi dhe largimi nga ajo që Ai na e ndaloi. Prej llojeve të adhurimit që duhet bërë janë: namazi, agjërimi, respektimi i prindërve, bamirësia ndaj njerëzve, etj.

Në anën tjetër, Allahu na ndaloi nga gjërat që janë të ndyta dhe të këqija, si: sharja, hidhërimi i prindërve, vjedhja, keqbërja, etj.

Dikush mund të pyesë: Përse duhet ta adhurojmë Allahun?

Përgjigja e vetme është:

Ngase Allahu i lartësuar është i vetmi Krijues i tokës dhe i qiellit, i kodrave dhe i lumenjve, i njerëzve dhe i shtazëve. Ai, i madhëruar qoftë, është Sunduesi i të gjitha krijesave; Ai krijoi çdo gjë prej asgjëje. Ne, gjithashtu, e adhurojmë Atë, sepse Ai, pasi që na krijoi, na dhuroi shumë të mira, na e nënshtroi çdo send që është mbi tokë dhe prej saj na caktoi atë që është hallall (e lejuar) dhe atë që është haram (e ndaluar). Ai ka pushtet mbi ne dhe mbi atë që posedojmë. Ai është Sunduesi ynë dhe i çdo sendi në ekzistencë. Ai na e bëri obligim nënshtrimin ndaj Tij dhe na urdhëroi që të mos adhurojmë askënd, përveç Tij. Dhe ne e adhurojmë Atë nga dashuria që kemi ndaj Tij. Allahu i Madhëruar thotë:

"Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t'ju dojë..."<sup>16</sup>

E adhurojmë Allahun nga lakmia që kemi për Xhenetin e Tij. Allahu i lartësuar thotë:

"... Allahu ju thërret për në Xhenet dhe për falje me lejen e Tij ..." <sup>17</sup>

Gjithashtu, e adhurojmë Atë për të shpëtuar nga Zjarri dhe nga frika prej tij:

"Zoti ynë, atë që Ti e fut në zjarr, e ke poshtëruar."<sup>18</sup>

Atëherë, kush është fitimtar në këtë botë e kush është i humbur?

Fitimtar është ai, që i kryen urdhrat e Allahut dhe obligimet që i ka ndaj Tij. I shpëtuar është ai, që largohet nga ajo që e hidhëron Allahun dhe nga ajo që Ai ka ndaluar.

Kurse, i humbur është ai, që e kundërshton Allahun dhe nuk i respekton urdhrat dhe obligimet e Tij. I humbur është ai, që nuk e adhuron Allahun. Ka dështuar ai, që i shkel ndalimet dhe bën gjëra nga të cilat na ka ndaluar Furnizuesi dhe Zotëruesi ynë. Ky është i humbur. Allahu i madhëruar thotë:

"... kush i shmanget Zjarrit e hyn në Xhenet, shpëton ..." <sup>19</sup>

Prej llojeve të rëndësishme të ibadetit të cilin e lënë pas dore shumica e njerëzve është duaja (lutja). Allahu i lartësuar thotë:

"Zoti juaj tha: 'Më thirrni Mua, Unë do t'ju përgjigjem. E ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të poshtëruar në Xhehenem.'" <sup>20</sup>

---

<sup>16</sup> Ali Imran, 31.

<sup>17</sup> el-Bekare, 221.

<sup>18</sup> Ali Imran, 196.

<sup>19</sup> Ali Imran, 185.

Pejgamberi ﷺ thotë: "Duaja është adhurim."

Prandaj, kur të dëshirosh që Allahu të të japë ndonjë gjë, thirre Atë dhe thuaj: "O Zot, më fut në Xhenet!", "O Zot, më shpëto nga Zjarri!", "O Zot, fali prindërit e mi!"

Kështu vepron për çdo çështje prej çështjeve të kësaj bote apo tjetrës. Kur ta lusësh Allahun, duhet të besosh bindshëm se Ai është i vetmi Krijues dhe Sundues yti dhe është i Gjithëfuqishëm që t'i përgjigjet lutjes sate.

Lutja jote drejtuar Allahut është ajka e adhurimit tënd dhe sinqeriteti i besimit tënd ndaj Allahut të madhëruar. Për këtë arsye, ti e lut vetëm Allahun dhe nuk e lut askënd prej krijesave të Tij, nuk kërkon nga askush prej krijesave të Tij, dhe nuk kërkon ndihmë nga askush tjetër përveç Tij.

---

<sup>20</sup> Gafir, 60.



**SHIRKU**

Vrasja me paramendim, dhunimi, keqtrajtimi i fëmijëve, gjenocidi. Këto janë krimet që ndodhin sot në botën tonë. Shumë prej jush mendojnë që këto janë veprat më të rënda që mund të bëhen. Mirëpo, ka diçka që ia tejkalon këtyre akteve, edhe nëse i bashkojmë që të gjitha. Ky krim është Shirku - adhurimi i shumë zotave (idhujtaria).

Disa njerëz mund të kenë dyshim rreth këtij konstatimi, mirëpo, nëse kjo shqyrtohet në kontekstin e duhur, do të vërejmë se nuk ka krim më të rëndë sesa Shirku, dhe kjo do të qartësohet për çdokënd që me sinqeritet i qaset kësaj teme. Nuk ka dyshim se krimet e cekura në rreshtin e parë janë krime të rënda dhe të tmerrshme. Mirëpo, nëse të gjitha këto krahasohen me Shirkun (idhujtarinë), nuk fitojnë peshën e rëndë të gjynahut që mban vetë Shirku. Kur njeriu kryen vrasje me paramendim, vjedhje a dhunim, kjo drejtpërdrejt ndikon negativisht dhe seriozisht në qeniet tjera njerëzore. Mirëpo, nëse njeriu bën Shirk, kjo ndikon tmerrësisht drejtpërdrejt në Krijuesin e botëve. Kur një njeri vritet, nga kjo mund të nxirren të gjitha motivet dhe arsytet e krimit. Mirëpo, një gjë që vrasësi nuk mund ta pohojë është se personi i vrarë nuk ka qenë dikush që i ka siguruar atij ushqim, veshmbathje, strehim, shëndet dhe gjëra të tjera që i nevojiten qenieve njerëzore.

Kurse, kur një person bën Shirk, me apo pa dashje, bën një gjynah të rëndë ndaj Atij që na furnizon me ushqim, veshmbathje, familje, jetë, shëndet, dhe shumë e shumë dhunti e begati të tjera të panumërta. Ky Furnizues është Allahu i lartësuar, Ai që të gjithëve na jep gjërat për të cilat kemi më së shumti nevojë në jetë. Pra, a është e drejtë që të kryhet krim kundër Atij që na furnizon të gjithë ne me të gjitha të mirat e mundshme?

Çka është Shirk saktësisht?

Shirku, në të vërtetë, është e kundërta e besimit në një Zot. Në aspektin gjuhësor, Shirk do të thotë t'i shoqërosh ortak dikujt, ndërsa në fenë Islame kjo do të thotë t'i shoqërosh rival (ortak) Allahut në kuptimin që t'u japësh krijesave të Allahut cilësi që, në të vërtetë, i takojnë vetëm Atij. Kjo automatikisht nënkupton të adhurohet diçka tjetër në vend të Allahut. Qëllimi i krijimit tonë është bërë i qartë në Kuranin fisnik, ku Allahu i madhëruar thotë:

“Unë nuk i krijova xhinët<sup>21</sup> dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”<sup>22</sup>

Qëllimi i krijimit tonë në këtë botë është që ta adhurojmë vetëm Allahun fuqiptotë. Duke bërë shirk personi përfundon në mohimin (refuzimin) e qëllimit të këtij krijimi. Ky gjynah tek Allahu është shumë i rëndë dhe nuk falet. Këtë e bën të qartë Allahu i lartësuar, kur thotë në Kuran:

“S’ka dyshim se Allahu nuk fal që t’i përshkruhet Atij ortak (idhujtarinë), e, përpos këtij (gjynahu), ia fal kujt të dojë. Kush i përshkruan Allahut ortak, ai ka bërë një gjynah të madh.”<sup>23</sup>

Nga ky ajet Kuranor mësojmë se gjithçka tjetër përveç Shirkut mund të falet. Megjithatë, nuk bën të keqkuptohet fakti se të gjithë që bëjnë shirk do të dënohen. Allahu e quan veten e Tij el-Gafûr (Falësi i madh), që është shumë e vërtetë. Nëse personi bën Shirk e më pas pendohet për një gjë të tillë tek Allahu, Ai ia pranon pendimin dhe ia shlyen gjynahun. Mirëpo, nëse personi nuk pendohet gjatë jetës së tij tek Allahu i lartësuar, atëherë Allahu atij nuk do t’ia falë këtë gjynah në Ditën e Gjykimit. Dënimi me zjarr do të jetë i përhershëm për atë person dhe ai nuk do të dalë nga Xhehenemi kurrë.

<sup>21</sup> Xhinët janë krijesa tjera të Allahut të krijuara nga zjarri pa tym. Sikurse prej njerëzve, edhe prej tyre kërkohet që ta adhurojnë Allahun e plotfuqishëm.

<sup>22</sup> edh-Dharijatë, 56.

<sup>23</sup> en-Nisa, 48.

Duhet, gjithashtu, që ta kemi parasysh edhe atë se Allahu me Gjykimin e Tij për gjynahe nuk i bën padrejtësi askujt. Nëse një musliman bën Shirk gjatë jetës së tij dhe nuk pendohet për këtë, edhe ai do të përfundojë në Zjarr të Xhehenemit. Ky realitet i ndihmon muslimanit të mos ndihet i vetëkënaqur dhe arrogant sikurse disa nga popujt e mëhershëm.

Disa njerëz mund të thonë se dënimi me Zjarr është i padrejtë. Mirëpo, këta duhet ta dinë se Allahu është më i drejti. Përderisa disa do të qëndrojnë në Zjarr të Xhehenemit përgjithmonë, për shkak të Shirkut që e kanë bërë, të tjerët do të hyjnë në Xhenet, ku do të jenë përgjithmonë, për shkak të besimit të tyre të pastër. Ata që thonë se Allahu është i padrejtë, për shkak të dënimit të Tij ndaj disa njerëzve me Zjarr të përjetshëm, ata, gjithashtu, duhet të thonë se Allahu është i padrejtë edhe për shkak të shpërblimit të Tij që ua jep njerëzve me Xhenet të përjetshëm! Personat që pa kurrfarë të drejte i thonë këto gjëra, nuk do ta refuzonin për vetët e tyre asnjëherë shpërblimin e përhershëm të Xhenetit. Këta persona me këto pohime tregojnë një shkallë të ulët dhe të dobët të të kuptuarit e argumenteve të qarta.

Kur njeriu bën Shirk, duhet ta kemi parasysh një fakt se në asnjë mënyrë kjo nuk e dëmton Allahun. Me këtë gjynah njerëzit vetëm i vejnë veten e tyre në rrezik të dënohen nga Allahu. Kjo nënkupton t'ia kthesh shpinën në mënyrë poshtëruese Allahut, i Cili ka bërë mirësi të mëdha ndaj nesh. Edhe pse kryhet gjynahu i Shirkut, kjo në asnjë mënyrë nuk e dëmton Allahun, madhështinë dhe mirësinë e Tij.

Për të kuptuar më lehtë sesi manifestohet shirku në jetën tonë, duhet të mësojmë se çfarë lidhje ka Shirku me besimin në një Zot.

Së pari, Shirku në zotërimin e Allahut. Ne si muslimanë besojmë që Allahu ka kontroll absolut, mbikëqyr dhe e furnizon gjithë universin. Ata që e bëjnë këtë lloj Shirku, ende besojnë se Allahu është Krijuesi i gjithë gjithësisë, mirëpo disa pjesë të këtij krijimi

(krijesa) kryejnë disa role në këtë botë. Një shembull klasik për këtë është edhe koncepti i Trinisë së shenjtë (I Ati, i Biri, dhe Shpirti i shenjtë) që gjendet te të krishterët. Të krishterët besojnë se vetëm Zoti nuk i rregullon punët e qenieve njerëzore. Ata besojnë se dy pjesët e tjera të Trinisë, Jezusi dhe Shpirti i shenjtë, gjithashtu kryejnë rol në jetën e njerëzve. P.sh. Jezusi, sipas tyre, shpall Ditën e Gjykimit, ndërsa Shpirti i shenjtë u ndihmon të krishterëve në jetën e tyre të përditshme, cilësi që i takojnë vetëm Allahut fuqiptotë.

Në anën tjetër, edhe Hindusët bëjnë një Shirk të tillë duke i marrë disa qindra zota të ndryshëm për t'i rregulluar aspektet e ndryshme të jetës së tyre.

Fatkeqësisht, edhe disa muslimanë kanë rënë në këtë lloj Shirkut duke kërkuar ndihmë dhe mbështetje prej njerëzve të mirë e të "shenjtë" që kanë vdekur.

Pastaj kemi Shirkun në mohim të Zotit. Përgjatë shekujve, shumë filozofë dhe të tjerë e kanë mohuar ekzistencën e Allahut. Budizmi dhe Xhainizmi janë ndër fetë më të mëdha të botës që kanë koncepte të tilla të besimit. Gjatë shekullit 18 dhe 19, përparimi i shkencës bëri që shumë "shkencëtarë" të deklarorin se Zoti na paska qenë vetëm pjellë e imagjinatës njerëzore. Duke mohuar ekzistencën e Ligjvënësit suprem, njerëzit që pohojnë se Zoti nuk ekziston, automatikisht i bëjnë vetët e tyre si zota të fatit të tyre.

Një aspekt tjetër i Shirkut është ta përshkruash Allahun me cilësi të njerëzve. Besimi në një Zot kërkon që të besohet Allahu me emrat dhe cilësitë e Tij dhe që këto, në asnjë mënyrë, nuk janë të ngjashme me ato të njerëzve. Ata njerëz që kryejnë gjynahun e kësaj kategorie, i përshkruajnë Zotit emra dhe cilësi që, në të vërtetë, u takojnë qenieve njerëzore. Të krishterët këtu prapë merren si shembull i kryerjes së këtij gjynahu të rëndë. Në Bibël, mund të gjeni shembuj të shumtë, ku Zotit i përshkruhen cilësi të cilat i takojnë vetëm qenieve njerëzore. Në Librin e Gjenezës (në

Bibël), thuhet se Zoti e krijoi tërë botën brenda gjashtë ditëve, pastaj në ditën e shtatë pushoi! Në vendet tjera në Bibël, gjejmë shembuj ku kinse Zoti është penduar për atë çfarë ka bërë dhe ka shprehur keqardhje!

Kjo formë e Shirkut disa njerëz i ka çuar përtej çmendurisë. Në Indi, shumë Hindusë e adhurojnë perëndinë Shinga Lingham. Ky është një idhull që paraqitet në formën e gjenitaleve mashkullore. Për Hindusët, kjo paraqet fuqinë riproduktive të Zotit. Hindusët e shprehin dashurinë për këtë idhull duke e lyer me qumësht, me gjalpë, me ujë, duke i ofruar bukë, etj.

Këto cilësi, që i përshkruhen Zotit, paraqesin një akt të madh mizorie ndaj Krijuesit të patëmeta. Allahu i lartësuar u përgjigjet këtyre injorantëve në Kuran duke thënë:

“Asgjë nuk është sikur Ai. Ai sheh gjithçka dhe dëgjon gjithçka.”<sup>24</sup>

Formë tjetër e Shirkut është hyjnizimi i qenieve njerëzore. Në këtë mënyrë, njerëzit ngriten në shkallë hyjnie nga injorantë të ndryshëm. Jezusi, Buda, Zaratustra, dhe figura tjera fetare të kohës së kaluar janë shndërruar në perëndi duke u konsideruar si personifikim i Zotit.

Pastaj kemi Shirkun në adhurim. Ne si muslimanë besojmë se të gjitha aktet e adhurimit duhet t'i drejtohen vetëm Allahut dhe të bëhen vetëm për Atë, të vetmin Zot të vërtetë. Njerëzit që fizikisht i bëjnë adhurimet për dikë tjetër përveç Allahut, bëjnë Shirk të madh. Duke e kryer këtë akt, njerëzit bëjnë padrejtësinë më të madhe në botë, e cila rezulton me vendosjen e tyre në skëterrën e Xhehenemit përgjithmonë. Të krishterët, zakonisht, të gjitha adhurimet e tyre i bëjnë jo në emër të Zotit. Prandaj, shumë të krishterë përkulen para statujave të Krishtit, të Marisë, dhe personave tjerë “të shenjtë” të krishterimit.

---

<sup>24</sup> esh-Shura, 11.

Edhe muslimanët kanë rënë në këtë kategori të Shirkut. Me mija ose miliona muslimanë injorantë i gjejmë sot duke bërë pelegrinazhe te varrezat e njerëzve të mirë dhe të “shenjtë.” Në këto varreza, këta muslimanë kryejnë vepra që e cenojnë rëndë besimin në një Zot duke therur kurbane për hir të shpirtave të njerëzve të vdekur dhe duke i qarkuar ato (si në Qabe). Shumë prej tyre, madje, kërkojnë nga të vdekurit që t’ua falin gjynahet që kanë bërë, t’ua plotësojnë dëshirat e fëmijëve të tyre, etj! Të gjitha këto vepra bien në kundërshtim të plotë me atë çfarë Allahu na urdhëron në Kuran:

“Thuaj: Me të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve.”<sup>25</sup>

Aspekt tjetër i Shirkut është bërja e veprave fetare sa për sy e faqe apo, siç quhet në terminologjinë fetare, Shirku i vogël.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم tha: “Gjëja nga e cila më së shumti frikohem për ju është Shirku i vogël.” Shokët e tij pyetën: “Na trego çka është Shirku i vogël, o i Dërguari i Allahut.” Pejgamberi صلى الله عليه وسلم tha: “T’i bësh gjërat sa për sy e faqe. Me të vërtetë, në Ditën e Gjykimit, Allahu do t’u thotë njerëzve, kur t’i marrin shpërblimet e tyre: ‘Shkoni tek ata të cilëve u lavdëroheshit në dynja dhe shihni se a do të merrni ndonjë shpërblim prej tyre.’”<sup>26</sup>

Çdo adhurim yni duhet të bëhet vetëm për hir të Allahut të patëmëta, i cili na mban të gjallë, na furnizon, na ushqyen, etj. Veprat nuk duhet të bëhen për t’i kënaqur ata që nuk kanë bërë gjë në krahasim me atë çfarë ka bërë Allahu për ne. Sot, shfaqja sa për sy e faqe dhe lavdërimi janë bërë sëmundje te shumë njerëz në mbarë botën, duke ua larguar kështu edhe atë sinqeritet të vogël që e kanë në zemrat e tyre.

<sup>25</sup> el- Enam, 162.

<sup>26</sup> Hadithi është i vërtetë. Përcillet nga Ahmedi, Bejhekiu dhe Taberani.

Njohja e rrezikut të Shirkut duhet të jetë mësim kryesor. Edhe muslimanët, edhe jomuslimanët duhet të dinë se gjynahet e Shirkut kanë bërë që bota të bjerë në këtë gjendje shkatërruese që tani është. Duke e larguar njeriun prej adhurimit të Allahut, Shirkut ka bërë që shumë njerëz t'i adhurojnë qeniet njerëzore duke e hapur kështu shtegun e tiranisë, të mizorisë e të shkatërrimit të botës dhe duke shkaktuar përfundimin në Zjarrin e përhershëm të Xhehenemit. Me të vërtetë, Shirkut (idhujtaria) është padrejtësia më e madhe në botë!

## BESËTYTNITË

Besëtytnia ndodh rreth një gjëje që shihet apo dëgjohet, për shkak të së cilës personi e ndërron mendjen për udhëtimin apo refuzon të bëjë diçka që paraprakisht kishte vendosur të bëjë. Kjo është Shirkut dhe kundërshton mbështetjen në Allahun e lartësuar. Në këtë mënyrë personi i hap derën frikës dhe mbështetjes në diçka tjetër veç Allahut. Besëtytnia e bazuar në diçka që ai sheh apo dëgjon e nxjerr atë nga pozita që përmendet në ajetet vijuese:

“Vetëm Ty (Allah) të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”<sup>27</sup>

“Adhuroni Atë dhe zini besë Atij”<sup>28</sup>

“Në Atë besoj dhe Atij i pendohem.”<sup>29</sup>

Kështu, zemra e personit lidhet për diçka tjetër veç Allahut në kuptimin e adhurimit dhe varësisë. Zemra dhe besimi i tij prishen, ai vazhdimisht shqetësohet nga këto ide besëtyte, ndërsa shejtani nga kjo e çon te gjërat që do ta dëmtojnë interesin e tij fetar dhe të kësaj bote. Sa e sa njerëz janë shkatërruar nga kjo si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën!

<sup>27</sup> el-Fatiha, 1.

<sup>28</sup> Hud, 123.

<sup>29</sup> Hud, 88.

Si mund të krahasohet kjo me optimizmin e drejtë, i cili i sjell lumturi zemrës, forcon shpresën, shtyp frikën, e rehaton dhe e motivon njeriun për të kërkuar ndihmë nga Allahu, për t'i zënë besë Atij dhe për të qenë i gëzuar? Ky optimizëm e çon personin në bindje ndaj Allahut dhe e bën të besojë vetëm në Të, kurse besëtytnia e çon personin në mosbindje ndaj Tij dhe e shtyn atë të shoqërojë të tjerë në adhurimin ndaj Tij (Shirk). Për këtë shkak, pejgamberi ﷺ e pëlqente optimizmin, ndërsa besëtytninë e shpalli të pavlefshme. Allahu i lartësuar nuk e përmend besëtytninë, veçse në anën e armiqve të të Dërguarve, meqë ata u drejtoheshin të Dërguarve duke u thënë:

“Sa për neve, në po shohim ogur të keq në juve. Nëse nuk ndaleni, me siguri, do t'ju vrasim me gurë dhe do të keni një ndëshkim të rëndë prej nesh.’ Ata (të Dërguarit) thanë: ‘Oguret e këqija qofshin në ju! A (E quani ogur të keq) vetëm sepse po këshilloheni?! Kurrsesi! Po ju jeni që tejkaloni kufijtë në mosbindje.”<sup>30</sup>

Allahu fuqimadh na tregon rreth ithtarëve të Faraonit:

“Por, kurdo që u ndodhnin gjëra të mira, thoshin: ‘Këtë e bëmë ne,’ e, nëse i godiste e keqja, e përshkruanin si ogur të keq që kishte të bënte me Musën dhe ata me të. Ta dini se oguret e tyre të këqija janë nga Allahu (i Cili ua hedh ato tyre).”<sup>31</sup>

Nëse personi ia hap dyert besëtytnisë, bota do të bëhet një vend i vështirë për të dhe ai çdo gjë do ta mendojë si ogur të keq. Ka njerëz të cilët, nëse zgjohen në mëngjes dhe e takojnë një njeri me një sy, e konsiderojnë këtë si ogur të keq dhe thonë: “Sot është ditë e keqe,” kështu që i tilli e mbyll dyqanin e tij dhe nuk shet apo nuk blen ndonjë gjë. Disa prej tyre e konsiderojnë ditën e mërkurë si ta pafat dhe thonë se kjo është një ditë e ogureve të këqija. Disa të

<sup>30</sup> Ja-Sin, 18-19.

<sup>31</sup> el-Araf, 131.



tjerë e konsideronin muajin *shewal* (kohën mes dy bajrameve) si të pafat, sidomos për martesë, por rasti i Aishes عنها رضي الله عنها dëshmon se kjo besëtytni është e gabuar, sepse pejgamberi صلى الله عليه وسلم u martua me të në këtë kohë.

Gjëja me rëndësi është se askush s'duhet t'i kushtojë vëmendje një besëtytnie, sepse ajo do t'ia prish jetën. Ajo çfarë duhet të bëjmë është ta ndjekim shembullin e pejgamberit صلى الله عليه وسلم, i cili e pëlqente optimizmin, siç është përcjellë në hadithet e vërteta. Ne duhet të jemi optimistë, jo pesimistë si disa njerëz që, kohë pas kohe, përpiqen të bëjnë ndonjë gjë e pastaj bëhen pesimistë dhe mendojnë se kurrë s'do ta arrijnë atë, kështu që heqin dorë. Kjo është gabim, sepse, nëse mendoni se diçka është e mirë, nuk duhet të hiqni dorë në orvatjen e parë. Përpiquni vazhdimisht, derisa t'jua lehtësojë Allahu i lartësuar.

## SHEMBUJ NGA BESËTYTNITË

Besimet e përvijuara më poshtë, janë besime te kota, që bien në kundërshtim me besimin e pastër Islam. Nëse disa nga këto personi i bën me vetëdije, duke qenë i informuar për paligjshmërinë e tyre, del nga kuadri i Islamit, sepse një pjesë e madhe e tyre janë Shirk ndaj Allahut si nga aspekti i zotërimit të Allahut, ashtu edhe nga ai i adhurimit ndaj Tij.

- Të konsideruarit e patkoit të kalit si fatsjellës. Zakonisht, vendoset në derë apo në automjet.
- Sakrifikimi i kurbaneve në disa varre dhe tyrbe.
- Therja e kurbanit dhe derdhja e gjakut gjatë pritjes së personaliteteve të mëdha, për udhëtim, etj.
- Të konsideruarit si ogurzezë ditën e 13-të të muajit.
- Lidhja e shamive në tyrbe, gjuajta e parave, shpërndarja e sheqerkave dhe kripës nëpër tyrbe, si dhe kërkimi i ndihmës nga te vdekurit që janë aty.

- Vendosja e një guri të kaltër dhe përdorimi i plumbit, me qëllim të mbrojtjes nga mësyshi.
- Besimi në personat që thonë se i njohin çështjet e fshehta (falltarët, astrologët, magjistarët, etj)
- Besimi se kalimi i lepurit përpara automjetit është fatkeqësi.
- Besimi se thyerja e gotës është tregues i mirësisë.
- Besimi se thyerja e pasqyrës paralajmëron fatkeqësi.
- Besimi se në atë shtëpi ku këndon huti apo korbi i zi vdes dikush.
- Besimi se, nëse personi nis për gurbet dhe mbrapa tij i hidhet uji, nuk do të ballafaqohet me ndonjë të keqe dhe do të kthehet shpejt nga gurbeti.
- Besimi se zënia e hënës apo e diellit tregon vdekjen e njerëzve të mëdhenj dhe të famshëm.
- Besimi se, nëse zihet hëna dhe dielli, në atë vit do të shfaqet uria, lufta dhe kundërshtimet.
- Gruaja që lind, nuk largohet (jashtë shtëpisë) 7 ditë. Nëse largohet, xhinët vijnë dhe marrin fëmijën dhe e ndërrojnë me një fëmijë tjetër.
- Besimi se, nëse fëmijës i puth këmbën poshtë, ai do të ecë herët.
- Besimi se, nëse kalohet përmbi fëmijën, ai mbetet i shkurtër.
- Besimi se, nëse nga një shtëpi del kufoma, duhet të zbrazen enët e ujit. Nëse nuk zbrazen, mund të vdesë edhe një tjetër person, për shkak se engjëllit i vdekjes prek ujërat.
- Besimi se, gjatë kalimit të funeralit, nuk bën të shikohet në thonjtë.
- Besimi se shtëpia e vdekurit duhet t'i ushqejë ata që vijnë, të shpërndajë hallvë në netët e 40-ta dhe të 52-ta për të vdekurin.
- Besimi se duhet prerë kurban për të vdekurit dhe të pritet ndihmë pas kësaj.
- Besimi se larja e teshave ditën e shtunë sjell fatkeqësi.
- Besimi se, kush kalon përfund ylberit, e ndërrohet gjininë.
- Varja e këpucëve dhe kokave të kafshëve në mur, me qëllim të plotësimit të disa dëshirave.
- Besimi se, nëse gërshetohen duart, ngatërrohet fati.

- Besimi se, nëse lidhen teshat në një lis të caktuar, kalojnë pikëllimet dhe shqetësimet.
- Të konsideruarit si fatkeqësi lehjen e qenit, krakëllimën e korbit dhe këndimin e hutit gjatë thirrjes së ezanit.
- Besimi se, nëse priten thonjtë në mbrëmje, shkurtohet jeta.
- Të konsideruarit si fatkeqësi dhe gjynah qepjen në mbrëmje.
- Besimi se nuk bën të qepet tesha, kur është e veshur.
- Besimi se, kur vjen nusja për herë të parë në shtëpi dhe kalon në mes dy këmbëve të vjehrrit, ajo bëhet e respektueshme.
- Besimi se duhet të shkohet nëpër tyrbe dhe të ndizet qiri, që të çilet fati i femrës.
- Të konsideruarit si fatkeqësi fillimin e punës, pastrimin dhe daljen në rrugë në ditët e caktuara të javës.
- Besimi se nuk është mirë të ulet në pragun e derës...

Këta janë disa shembuj të besëtytnive që zakonisht i hasim te shumë njerëz dhe nuk janë të vetmet. Shembujt e përvijuar i sollëm sa për të treguar natyrën e besëtytnive, në mënyrë që, nëse hasni në besime të ngjashme e që nuk kanë bazë në parimet fetare, të mos i veproni dhe të paralajmëroni kundër tyre.

## ISLAMI DHE IMANI (BESIMI)

Islami dhe Imani janë nivele të fesë. Sipas një hadithi, kur pejgamberi ﷺ u pyet se çka është Islami, u përgjigj:

"Islam është që të dëshmosh se s'ka të denjë për adhurim, përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij; ta falësh namazin, ta japësh zekatin, ta agjërosh ramazanin, dhe ta bësh haxhin te Shtëpia (Qabja), nëse ke mundësi për këtë".

Dhe, kur u pyet rreth Imanit, ai ﷺ u përgjigj:

"Iman është që të besosh në Allahun, në engjëjt e Tij, në Librat e Tij, në të Dërguarit e Tij, në Ditën e Fundit, dhe të besosh në paracaktimin hyjnor (Kaderin), të mirën dhe të keqen e tij."<sup>32</sup>

Rreth këtij kategorizimi, Allahu fuqiptotë thotë në Kuran:

"Beduinët thonë: 'Besojmë.' Thuaj: 'Ju nuk po besoni, por thoni: Jemi dorëzuar (në Islam),' meqë besimi (Imani) ende nuk ka hyrë në zemrat tuaja."<sup>33</sup>

Domethënë, në fazat e hershme të çështjes së tyre, Imani ende nuk kishte zënë vend në zemrat e tyre. Dhe, edhe nëse kishin Iman, ishte i pakët.

Pra, bazuar në këtë, Islami është bindje së jashtmi, kurse Imani është bindje së brendshmi, dhe kjo vlen kur Islami dhe Imani përmenden së bashku.

Për sa i përket rastit kur Islami apo Imani përmenden veças, atëherë secili mbart domethënien e tjetrit; kur përmendet vetëm

---

<sup>32</sup> Buhari, Muslim.

<sup>33</sup> el-Huxhuratë, 14.

Islami, edhe Imani përfshihet në të; kur përmendet vetëm Imani, edhe Islami përfshihet në të.

Pra, Imani është fjalë gjuhe, vepër gjymtyrësh dhe vërtetim me zemër. Ky përcaktim përfshin edhe Islamin, i cili, po ashtu, është fjalë gjuhe, vepër gjymtyrësh dhe vërtetim me zemër.

## KUSHTET (SHTYLLAT) E ISLAMIT

Islami bazohet në pesë shtylla, të cilat na i shpjegoi i Dërguari ﷺ, kur tha:

“Islami ndërtohet mbi pesë (shtylla): dëshmimi se s’ka të denjë për adhurim, përveç Allahut, dhe Muhamedi është i Dërguar i Allahut; falja e rregullt e namazit, dhënia e zekati, shkuarja në Haxh, dhe agjërimi i muajit të ramazanit.”<sup>34</sup>

Islami ndërthen në vete besim dhe ligje në të cilat Allahu dhe i Dërguari i Tij nga tregojnë çka është hallall dhe çka është haram, na tregojnë për moralin e mirësjelljen, për aktet e adhurimit, si të bashkëveprojmë me njerëzit, për obligimet dhe të drejtat e ndërsjella, si dhe për skenat e ringjalljes. Kur Allahu fuqimadh e kompletoi këtë fe, Ai e zgjodhi të jetë mënyrë jetese për tërë njerëzimin, deri në Ditën e Kijametit:

“Në këtë ditë, jua përsosa fenë tuaj për ju, plotësova favorin Tim ndaj jush dhe zgjodha për ju Islamin si fe.”<sup>35</sup>

Këto në vijim janë shtyllat e Islamit apo parimet mbi të cilat ai bazohet:

### Shtylla e parë: Dy dëshmitë (shehadeti)

Dëshmimi:

<sup>34</sup> el-Buhari, nr.8

<sup>35</sup> el-Ma’ideh, 3.

*Eshhedu en la ilahe il-la Allah we eshedu enne  
Muhamedun resulullah*

Dëshmoj që s'ka të denjë për adhurim, përveç  
Allahut, dhe dëshmoj që Muhamedi është i Dërguar i  
Allahut

Kjo do të thotë që personi të besojë se vetëm Allahut është Zot, Sundues e Kontrollues, Krijues e Furnizues; që t'i pohojë të gjithë emrat e bukur dhe cilësitë e lartësuar që Allahu i ka pohuar për veten e Tij apo që pejgamberi i Tij i ka pohuar për Të; dhe që të besojë se vetëm Allahu është i denjë për t'u adhuruar, siç thotë Ai:

“Ai është Shpikësi i qiejve dhe i tokës. Si të ketë fëmijë Ai, kur nuk ka grua!? Ai i krijoi të gjitha gjërat dhe Ai është i gjithëdijshëm. Kështu është Allahu, Zoti juaj. Askush s'është i denjë për adhurim, përveç Tij, Krijuesit të të gjitha gjërave. Pra, adhuroni Atë. Dhe Ai është Kujdestari i të gjitha gjërave.”<sup>36</sup>

Duhet të theksohet se kjo dëshmi ngrihet mbi dy baza: Mohimin dhe Pohimin.

*La il-lahel*/"Nuk ka të denjë për adhurim" është mohim. Pra, me këtë pjesë të dëshmisë, hidhen poshtë të gjitha llojet e besimeve të kota dhe mohohen të gjithë ata që padrejtësisht adhurohen në vend të Allahut.

*il-la Allah!*/"përveç Allahut" është vërtetim. Domethënë, në një anë, me këtë pohohet dhe vërtetohet se nuk ka të denjë për adhurim, përveç Allahut, kurse, në anën tjetër, bëhet e detyrueshme puna për realizimin e këtij adhurimi.

Për ta pasur më të qartë se çka kërkohet prej nesh me thënien e kësaj shprehjeje, ne, patjetër, duhet të merremi me kushtet e saj. Dijetarët, në bazë të argumenteve të qarta të Sheriatit, kanë ardhur

---

<sup>36</sup> el-En'am, 101-102.

në përfundim se kjo shprehje i ka 7 kushte të cilat duhet të plotësohen, në mënyrë që dëshmia të jetë e vlefshme.

- Kushti i parë: Dituria

Kushti i parë i këtyre fjalëve është dituria rreth tyre, çka nënkupton që, secili që e thotë këto shprehje, duhet ta dijë se vetëm Allahu duhet të adhurohet dhe nuk lejohet t'i bëhet rival askush dhe asgjë në këtë adhurim. Allahu i madhëruar thotë:

“Dije se nuk ka të denjë për adhurim, përveç Allahut. Kërko falje për gjynahun tënd dhe për besimtarët! Allahu e di se si silleni ju dhe ku qëndroni.”<sup>37</sup>

- Kushti i dytë: Bindja

Ai i cili e thotë këtë shprehje, përveçqë duhet ta kuptojë, ai duhet edhe të jetë i bindur në atë që shpreh ajo. Nëse personi e di kuptimin e drejtë të kësaj shprehjeje, por dyshon në të, ai nuk do të përfitojë atë që duhet. Allahu i madhëruar thotë:

“Besimtarë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë...”<sup>38</sup>

- Kushti i tretë: Pranimi

Pasi të kemi kuptuar dhe të jemi bindur në atë që shpreh kjo frazë, na mbetet ta pranojmë me zemër dhe me gjuhë tërë atë me të cilën erdhi ajo. Jobsimtarët nuk ishin në gjendje ta pranonin realitetin që solli kjo frazë, madje e mohuan dhe e refuzuan me kryelartësi e përbuzje. Allahu i madhëruar thotë:

“Atë ditë, të gjithë do të jenë së bashku në dënim. Kështu ne veprojmë me keqbërësit, sepse, kur atyre u thuhej se nuk ka të

---

<sup>37</sup> Muhamed, 19.

<sup>38</sup> Huxhuratë, 15.

denjë për adhurim, përveç Allahut, ata tregoheshin mendjemëdhenj dhe thoshin: 'Vallë, a t'i braktisim hyjnitë tona ...'"<sup>39</sup>

#### - Kushti i katërt – Nënshtrimi

Pasi të kemi pranuar me zemër dhe me gjuhë tërë atë me të cilën erdhi kjo frazë, duhet të vazhdojmë t'u nënshtrohemi kërkesave të saj me gjymtyrët tona. Andaj, në bazë të këtij kushti, kuptojmë se nuk mjafton pretendimi se kemi zemër të pastër apo që thjesht jemi muslimanë, por, medoemos, duhet ta dëshmojmë këtë nënshtrim me veprat tona. Allahu i patëmeta thotë:

"Kush ia dorëzon veten Allahut (i nënshtrohet Atij) duke qenë mirëbërës, ai është kapur për vegën më të fortë. Tek Allahu do të kthehet çdo gjë..."<sup>40</sup>

#### - Kushti i pestë - Vërtetësia

Personi duhet ta thotë dhe ta pranojë këtë shprehje me vërtetësi të plotë, të pastër nga çdo njollë e gënjeshtërsë. Allahu i plotfuqishëm thotë:

"Elif. Lamë. Mimë. A menduan njerëzit të thonë 'besojmë' e të mos vihen në sprovë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre dhe, gjithsesi, Allahu do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën dhe do t'i dallojë gënjeshtarët."<sup>41</sup>

#### - Kushti i gjashtë – Sinqeriteti

Personi duhet të jetë i sinqertë gjatë kryerjes së veprave të cilat i obligohen me thënien e këtij dëshmimi. Ai duhet të jetë i sinqertë dhe t'i kryejë ato vetëm si nënshtrim ndaj Allahut të madhëruar.

<sup>39</sup> Safatë, 33-36.

<sup>40</sup> Lukman, 22.

<sup>41</sup> el Ankebutë, 1-3.



Thënësi i kësaj fjale duhet të mundohet maksimalisht që të mos përvidhet në veprat e tij hipokrizia, e cila ndikon në cungimin e shpërblimit apo edhe në refuzimin e tërësishëm të veprës së tij. Allahu i lartësuar thotë:

“Duke qenë se ata nuk u urdhëruan për tjetër pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë...”<sup>42</sup>

- Kushti i shtatë – Dashuria dhe urrejtja

Dashuria dhe urrejtja duhet të bëhen në bazë të kësaj shprehjeje. Pra, besimtari i miqëson ata të cilët janë në pajtim me këtë shprehje dhe distancohet nga ata të cilët nuk janë të këtillë. Gjithashtu, ai i do ato vepra të cilat janë në përputhje me këtë shprehje dhe i urren ato të cilat janë në kundërshtim me të. Allahu fuqimadh thotë:

“Nuk gjen popull që beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit e ta dojë atë që e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, fëmijët e tyre, vëllezërit e tyre, farefisi i tyre...”<sup>43</sup>

Personi duhet të besojë që Allahu e dërgoi të Dërguarin e Tij, Muhamedin, dhe i shpalli atij Kuranin duke e urdhëruar që t’ua përcillte porosinë njerëzimit. Dhe personi duhet të besojë që ta duash Allahun dhe të Dërguarin e Tij si dhe bindja ndaj tyre janë obligime të domosdoshme për tërë njerëzimin, dhe që dashuria ndaj Allahut mund të realizohet vetëm duke ndjekur të Dërguarin e Tij:

---

<sup>42</sup> Bejjine, 5.

<sup>43</sup> Muxhadele, 22.

“Thuaj (njerëzimit, o Muhamed): ‘Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua, dhe Allahu do t’ju dojë dhe do t’jua falë gjynahet. Allahu fal shpesh dhe shumë.’”<sup>44</sup>

## Shtylla e dytë: Namazi

Muslimani beson që Allahu e ka urdhëruar çdo musliman të rritur e të shëndoshë mendërisht të falë pesë namaze brenda çdo dite (24 orë), gjë të cilën ai duhet ta bëjë në gjendje të pastër, duke qëndruar para Zotit të tij me përvullësi, duke e falënderuar Zotin e tij për bekimet që i ka dhënë, duke kërkuar prej Tij mirësi, duke kërkuar prej Tij falje të gjynaheve, duke i kërkuar Atij Xhenetin dhe shpëtimin nga Xhehenemi.

Pesë namazet e obligueshme të cilat kërkohen prej nesh për çdo ditë janë: Sabahu (në agim, para lindjes së diellit), Dreka (në mesditë), Ikindia (mbas dite), Akshami (menjëherë pasi të perëndoje dielli), dhe Jacia (natën, pasi të bjerë terri).

Islami bazohet në bashkëpunim, vëllazëri dhe dashuri, kështu që Allahu urdhëroi bashkimin e individëve për këto namaze, me qëllim që të arrihen këto vlera. Pejgamberi صلى الله عليه وسلم tha:

“Namazi i përbashkët (në xhemat) është 27 herë më i mirë sesa namazi i falur vetëm.”<sup>45</sup>

Namazi ndihmon në kohë të vështira dhe në fatkeqësi. Allahu i lartësuar thotë:

“Kërkoni ndihmë me durim e me namaz. Vërtet, kjo është e vështirë, përveç për ata që përnjëmend ia kanë frikën Allahun.”<sup>46</sup>

Pesë namazet ditore i shlyejnë gjynahet, siç tha pejgamberi صلى الله عليه وسلم :

<sup>44</sup> Aal Imran, 31.

<sup>45</sup> Muslim, 650.

<sup>46</sup> el-Bekare, 45.

“A mendoni që, sikur të ishte një lum para derës së ndokujt prej jush dhe ai të lahej pesë herë në ditë, do të mbetej në të papastërti?” Ata thanë: “S’do të mbetej aspak papastërti në të.” Ai tha: “Kështu është shembulli i pesë namazeve ditore nëpërmjet të cilave Allahu shlyen gjynahet.”

Namazi i bërë si duhet, me përukje dhe me frikë ndaj Allahut, e afron robin më shumë ndaj Allahut dhe e mban atë larg keqbërjes, siç thotë Allahu i patëmeta:

“Lexo atë që po të shpallet nga Libri (Kurani) dhe fal namazin, se vërtet që namazi parandalon nga gjynahet e mëdha dhe nga e urryera (mosbesimi, idhujtaria, etj).”<sup>47</sup>

### **Shtylla e tretë: Zekati (lëmosha e obligueshme)**

Mu siç Allahu krijoi njerëzit me ngjyra të ndryshme, qëndrime të ndryshme dhe nivele të ndryshme të dijes, ashtu dallojnë dhe veprat dhe mjetet e tyre të jetesës. Disa prej tyre Ai i bëri të pasur e disa i bëri të varfër, për t’i provuar të pasurit se a do të tregohen falënderues dhe për ta provuar të varfrin se a do të tregohet i duruar. Meqë besimtarët janë vëllezër dhe vëllazëria bazohet në dhembshuri, butësi, dashuri e mëshirë, Allahu i urdhëroi muslimanët për të dhënë zekatin, i cili merret nga të pasurit dhe u jepet të varfërve. Allahu i plotfuqishëm thotë:

“Merr sadaka (lëmoshë) nga pasuria e tyre që t’i pastrosh nga gjynahet dhe lute Allahu për ta, se vërtet që lutjet tua janë një burim sigurie për ta.”<sup>48</sup>

Zekati e pastron pasurinë dhe e pastron shpirtin nga koprracia. Ai e forcon dashurinë mes të pasurve dhe të varfërve, largon urrejtjen, bën që siguria të mbizotërojë dhe i sjell lumturi popullit musliman.

<sup>47</sup> el-Ankebut, 45.

<sup>48</sup> et-Tewbeh, 103.

Allahu e bëri obligim dhënien e zekatit për secilin që posedon sasinë minimale të pasurisë së tepruar (*nisab*) për një vit hënor, e cila mbërrin vlerën e 595 gramëve argjend apo të 85 gramëve ari.

*Nisabi* i parave të gatshme është i njëjtë me atë të argjendit dhe të arit. Tarifa e zekati në ari, argjend, metale tjera dhe mallra tregtie është çereku i 10% (dmth 2.5%). Në prodhimet bujqësore dhe fruta sasia është një e dhjeta, nëse nuk vaditet (artificialisht, por vaditet nga shiu etj). Sa u përket bagëtive, detajet gjenden në librat e jurisprudencës ...

Atij që jep zekatin Allahu ia shlyen gjynahet nëpërmjet kësaj, ia bekon pasurinë dhe ia përgatit një shpërblim të madh. Allahu lartësuar thotë:

“Falni namazin dhe jepni zekatin, dhe çfarëdo mirësie (punë që i do Allahu) që dërgoni për vetën tuaj do ta gjeni tek Allahu. Vërtet, Allahu sheh gjithë atë çfarë bëni.”<sup>49</sup>

Mosdhënia e zekati sjell fatkeqësi dhe të këqija mbi popullin musliman. Allahu fuqiptotë i ka kërcënuar ata që nuk e japin atë me një ndëshkim të dhembshëm në Ditën e Ringjalljes. Ai thotë:

“O ju që besoni, vërtet që ka shumë nga rabinët (çifutë) dhe murgjit (e krishterë) që hanë pasurinë e njerëzimit padrejtësisht dhe i pengojnë ata nga rruga e Allahut. Ata që grumbullojnë ari dhe argjend (për të cilat s’është dhënë zekati) dhe nuk e harxhojnë në rrugën e Allahut njoftoj për ndëshkim të dhembshëm. Në ditën kur (ajo që ata tubojnë) do të nxehet në Xhehenem dhe me të t’u fërkohen ballët e tyre, ijët e tyre dhe shpinat e tyre (dhe t’u thuhet): ‘Ky është thesari që e ruanit për vete. Shijoni atë që grumbulloni!’”<sup>50</sup>

---

<sup>49</sup> el-Bekareh, 110.

<sup>50</sup> et-Teubeh, 34-35.

Fshehja e dhënies së zekatit është më mirë, sesa dhënia e tij haptazi para njerëzve, siç thotë Allahu i lartësuar:

“Nëse e bëni publike sadakanë (lëmoshën) tuaj, është mirë. Por, nëse e fshihni atë dhe ia jepni të varfërve, kjo është më mirë për ju. (Allahu) Do t’jua shlyejë disa gjynahe që bëni. Allahu është i mirinformuar rreth asaj çfarë bëni.”<sup>51</sup>

Kur muslimani të japë zekatin, nuk është e lejueshme t’ia japë tjetërkujt pos atyre që Allahu i përmend në ajet:

“Sadakatë (këtu mendohet në zekatin) janë vetëm për fukarenjtë, për nevojtarët, për të angazhuarit në mbledhjen (e zekatit), për të joshur zemrat e atyre që anojnë nga Islami, për lirim të zënëve robër, për të zhyturit në borxhe, për rrugën e Allahut (luftëtarët në beteja), dhe për udhëtarin (që s’ka kurrfarë furnizimi). Kjo është detyrë e ngarkuar nga Allahu. Dhe Allahu është i gjithëdijsëm, i Urtë.”<sup>52</sup>

## **Shtylla e katërt: Agjërimi i ramazanit**

Agjërim do të thotë të përmbahesh nga gjërat që e prishin agjërimin, si: ushqimi, pija, dhe marrëdhënia seksuale, nga lindja e diellit deri në perëndim të tij, duke pasur qëllimin (nijetin) për të agjëruar.

Raporti mes durimit dhe besimit është sikur ai i kokës me trupin. Allahu i patëmeta e urdhëroi këtë popull për të agjëruar një muaj në vit, me qëllim që ata t’i afrohen më shumë Allahut, t’i shmangen asaj që e ndaloi Allahu, të mësojnë të bëjnë durim, ta vejnë unin nën kontroll, të garojnë në bujari, dhe të demonstrojnë bashkëpunimin dhe dhembshurinë e ndërsjellë. Allahu i lartësuar thotë:

---

<sup>51</sup> el-Bekare, 271.

<sup>52</sup> et-Teubeh, 60.

“O ju që besoni, ju është bërë obligim agjërimi ashtu siç u që bërë obligim atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.”<sup>53</sup>

Muaji i ramazanit është një muaj madhështor në të cilin Allahu i lartësuar e shpalli Kuranin. Në këtë muaj shumëzohet shpërblimi për punë të mira, për dhënie lëmoshe e për adhurime. Portat e Xhenetit hapen, kurse portat e Xhehenemit mbyllen, dhe shejtanët ndryhen.

Allahu i madhëruar e bëri obligim agjërimin e muajit të ramazanit për çdo musliman të rritur e të shëndoshë mendërisht, si për femrat, ashtu dhe për meshkujt, siç thotë Ai:

“Muaji i ramazanit në të cilin u shpall Kurani, udhëzim për njerëzimin dhe argument i qartë për udhëzimin, dhe kriter (mes të mirës dhe të keqes). Kushdo prej jush që sheh (hënën e re) ramazanin, duhet ta agjërojë këtë muaj; kushdo që është i sëmurë apo në udhëtim, numër ditësh të njëjta (duhet të kompensohen) nga ditët tjera. Allahu do lehtësim për ju e nuk do që t’jua vështirësojë. (Ai do) Që të plotësoni numrin e njëjtë të ditëve dhe që ju ta madhëroni Allahun, ngaqë ju udhëzoi dhe ju bëri mirënjohësi ndaj Tij.”<sup>54</sup>

## **Shtylla e pestë: Haxhi**

Allahu u dha një kibël (drejtim lutjeje) muslimanëve nga e cila ata kthehen, kur falin namazin dhe kur bëjnë lutje tjera, kudo që të jenë. Kjo kibël është Shtëpia e Lashtë (Qabja) në Meken e nderuar:

“Ktheni fytyrat në drejtim të Qabes. Kudo që të jeni, ktheni fytyrat (në namaz) në atë drejtim.”<sup>55</sup>

---

<sup>53</sup> el-Bekare, 183.

<sup>54</sup> el-Bekare, 185.

<sup>55</sup> el-Bekare, 144.

Kjo meqë muslimanët janë të shpërndarë në tërë botën dhe Islami i thërret njerëzit të bashkohen dhe ta njohin njëri-tjetrin, mu siç i thërret për t'u bashkëpunuar në drejtësi e devotshmëri, për t'ia rekomanduar njëri-tjetrit të vërtetën, për t'i thirrur njerëzit për tek Allahu dhe për të respektuar ritualet Islame. Prej këtui, Allahu i lartësuar ia bëri obligim çdo muslimani të rritur e të shëndoshë mendërisht vizitimin e Qabes, qarkimin rreth saj dhe kryerjen të gjitha ritualeve e Haxhit ashtu siç u shpjegua nga Allahu dhe nga i Dërguari i Tij ﷺ. Allahu i lartësuar thotë:

“Haxhi te Shtëpia (Qabja) është një obligim që njerëzimi i ka borxh Allahut, për ata që kanë mundësi. Kush mohon (Haxhin), atëherë Allahu s'ka nevojë për askënd në tërë botën.”<sup>56</sup>

Haxhi ka etiketën dhe kushtet e veta, të cilat duhet të zbatohen nga muslimanët, siç është ruajtja e gjuhës, e shikimit dhe e dëgjimit nga ajo që Allahu ndaloi; të qenët i sinqertë në qëllim, shfrytëzimi i parave nga burimet e shëndosha (për Haxh), mbajtja e qëndrimit më të mirë, dhe shmangia nga gjithçka që mund ta zhvlerësojë Haxhin, siç janë marrëdhëniet seksuale, gjynahu apo grindja e pavend, siç thotë Allahu i madhëruar:

“Haxhi bëhet në muajt e mirënjohur. Kushdo që ka për qëllim të kryejë Haxhin në këta muaj, nuk bën as të ketë marrëdhënie seksuale, as të bëjë gjynah, as të grindet gjatë Haxhit. Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di. Furnizohuni për udhëtim, por furnizimi më i mirë është devotshmëria. Pra, ma kini frikën Mua, o mendarë.”<sup>57</sup>

Nëse muslimani e kryen Haxhin si duhet, në mënyrën e urdhëruar dhe sinqerisht për hir të Allahut, do të jetë shlyerje gjynahesh për të. Pejgamberi ﷺ tha:

---

<sup>56</sup> Aal Imran, 97.

<sup>57</sup> el-Bekare, 197.

“Kush e kryen Haxhin për hir të Allahut dhe nuk bën marrëdhënie seksuale apo gjynah, do të kthehet ashtu siç e pat lindur nëna e tij.”<sup>58</sup>

## KUSHTET E IMANIT (BESIMIT)

### Kushti i parë: Besimi në Allahun

Kjo është të besosh që:

- Allahu është Një, pa ndonjë ortak/rival.
- Asgjë s’është si Ai.
- Asgjë s’mund ta mbizotërojë Atë.
- Nuk ka të denjë për adhurim, përveç Tij.
- Ai është i Përjetshmi, pa fillim dhe pa fund.
- Asgjë nuk ndodh, përveç asaj për të cilën Ai është i vullnetshëm.
- Asnjë imagjinatë s’mund ta përfytyrojë Atë dhe të kuptuarit s’mund ta përfshijë Atë.
- Ai ndryshon nga çdo qenie e krijuar.
- Ai është i gjallë dhe kurrë nuk vdes; është gjithmonë aktiv dhe kurrë nuk fle.
- Ai krijon pa qenë qenia e Tij e nevojshme për këtë dhe e furnizon krijimin e Tij pa ndonjë mundim.
- Ai e shkakton vdekjen pa pasur frikë dhe e rivendos jetën pa ndonjë vështirësi.
- Qysh para krijimit Ai ka ekzistuar me cilësitë e veta. Sjellja e krijesave në ekzistencë nga ana e Tij nuk i shtoi asgjë cilësive që Ai tashmë i kishte. Ashtu siç ka qenë para ekzistimit të gjërave, së bashku me cilësitë e Tija, ashtu do të mbetet përgjithmonë.
- Ai gjithmonë ka qenë Zot, edhe kur nuk ka pasur ndonjë gjë për të qenë Zot i saj, dhe gjithmonë ka qenë Krijues, edhe kur s’ka pasur krijesa.
- Ai ka fuqi/mundësi për të bërë çdo gjë. Çdo gjë varet prej Tij. Çdo gjë është lehtë për të dhe Ai s’ka nevojë për asgjë.

---

<sup>58</sup> el-Buhari, nr.15210.



- Ai e krijoi krijimin me diturinë e Tij.
- Ai e përcaktoi fatin për ata që i krijoi.
- Ai u caktoi atyre jetëgjatësi të caktuar.
- Asgjë në lidhje me ta s'ka qenë e fshehur për Të, para se Ai t'i krijonte ata, dhe Ai dinte çdo gjë që ata do të bënin para se t'i krijonte ata.
- Ai i urdhëroi ata për nënshtrim ndaj Tij dhe i ndaloi nga kundërshtimi ndaj Tij.
- Çdo gjë ndodh sipas vendimit dhe vullnetit të Tij, dhe vullneti i Tij është i përsosur.
- Ai i udhëzon kë të dojë, i mbron dhe i ruan ata nga e keqja, prej fisnikërisë që Ai ka. Dhe Ai e humb kë të dojë, i poshtëron dhe i dëmton ata, prej drejtësisë që Ai ka.
- Të gjithë i janë nënshtruar vullnetit të Tij në mes fisnikërisë së Tij dhe drejtësisë së Tij.
- Ai është i lartësuar përtej pasjes së ndonjë rivali apo të barabarti me Të.
- Askush s'mund t'i shmanget vendimit të Tij, të zbrapsë urdhrin e Tij apo t'i mbizotërojë çështjet e Tija.
- Në tërë këtë duhet të besohet dhe duhet të jemi të bindur se çdo gjë vjen prej Tij.

### **Kushti i dytë: Besimi në engjëjt**

Engjëjt janë krijesa prej krijesave të Allahut. Ato janë të padukshme, nuk hetohen e as nuk preken me dorë. Allahu i patëmeta i pastroi ato nga gabimi e devijimi dhe i ruajti nga gjynahet dhe të këqijat. Ata nuk janë sikurse njerëzit; ata nuk hanë, nuk pinë, nuk flenë. Ata janë botë tjetër, e cila ndryshon nga bota e njerëzve dhe nga bota e atyre të cilët ne i shohim. Gjëja kryesore me të cilën veçohen engjëjt nga njerëzit është adhurimi i shumtë që ata i bëjnë Allahut të madhëruar në vazhdimësi dhe pa përtaci. Allahu i madhëruar thotë:

"... ata nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë për çka urdhërohen"<sup>59</sup>;

"Atë (Allahun) e lavdërojnë natë e ditë dhe ata nuk mërzhiten (prej adhurimit)."<sup>60</sup>

Engjëjt janë krijesa të zgjedhura të Allahut. Allahu i lartësuar i zgjodhi ata për të kryer detyrën më të ndershme. A ka detyrë më të ndershme sesa përcjellja e Sheriatit deri te të Dërguarit dhe Lajmëtarët (pejgamberët) që ata t'i thërrasin njerëzit në adhurimin e të vetmit Allah? Kjo është detyra e ndershme, të cilën Allahu e zgjodhi për engjëjt. Allahu i madhëruar thotë:

"Falënderimi i qoftë Allahut, Sajuesit që i bëri engjëjt të Dërguar me nga dy palë, tri palë e katër palë krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. Vërtet, Allahu ka fuqi për çdo send."<sup>61</sup>

Nga cilësitë tjera me të cilat ata veçohen në krijim e për të cilat na ka informuar Allahu janë se ata kanë krahë ashtu siç u përmend në ajetin e lartpërmendur. Numri i krahëve të tyre është i ndryshëm. Prej tyre ka që kanë nga dy krahë, nga tre krahë, apo nga katër palë krahë, dhe ka prej tyre që kanë edhe më tepër se kaq, siç është rasti i Xhibrilit (alejhi selam), siç përcillet në hadithin e pejgamberit صلى الله عليه وسلم, ku ai e sheh Xhibrilin me gjashtëqind palë krahë.

Nga cilësitë e tyre, gjithashtu, është se ata kanë fuqi të ngriten dhe të zbresin mes qiejve dhe tokës me shpejtësi të madhe. Allahu i lartësuar thotë:

"Atje ngriten engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili) në një ditë që zgjatë pesëdhjetë mijë vjet."<sup>62</sup>

<sup>59</sup> et-Tahrim, 65.

<sup>60</sup> el-Fusilet, 38.

<sup>61</sup> el-Fatir, 1.

<sup>62</sup> Mearixh, 4.

Nga cilësitë e tyre është se ata janë të krijuara nga drita, siç përcillet nga pejgamberi صلى الله عليه وسلم. Ata posedojnë fuqi të jashtëzakonshme dhe, për këtë shkak, tetë prej tyre e mbajnë Arshin (Fronin) e Allahut. Allahu i madhëruar thotë:

" Dhe engjëjt do të qëndrojnë në anët e tij dhe, në atë ditë, tetë (engjëj) do të mbartin Arshin e Zotit tënd."<sup>63</sup>

Prej engjëjve ka të atillë që Allahu i madhëruar i caktoi për marrjen e shpirtave të njerëzve, kur ata të vdesin. Prijësi i këtyre engjëjve është Engjëlli i vdekjes, i cili ka ndihmëtarë tjerë prej engjëjve. Allahu i lartësuar thotë:

"... derisa t'i vijë ndonjërit prej jush vdekja e t'ia marrin shpirtin të dërguarit Tanë që bëjnë kurrfarë lëshimi."<sup>64</sup>

Nga engjëjt ka të atillë që Allahu i dërgon për t'u ndihmuar njerëzve besimtarë. Allahu i lartësuar thotë:

"Kur Zoti yt u kumtoi engjëjve se Unë jam me ju, pra, inkurajoni ata që besuan."<sup>65</sup>

Besimi ynë në këtë lloj engjëjsh na bënë të mundohemi për ta merituar inkurajimin me engjëj nga Allahu fuqiplotë.

Prej engjëjve ka të atillë që Allahu i ka obliguar për t'i shkruar veprat tona, të mirat e të këqijat. Allahu i lartësuar thotë:

"A mendojnë se Ne nuk e dëgjojmë ndjenjën e fshehtë të tyre dhe bisedën e tyre? Gjithsesi (e dëgjojmë), dhe të dërguarit tanë (engjëjt përcjellës) pranë tyre shkruajnë."<sup>66</sup>

---

<sup>63</sup> el-Hakka, 17.

<sup>64</sup> el-En'am, 61.

<sup>65</sup> el-Enfal, 12.

<sup>66</sup> ez-Zuhruf, 80.

Besimi ynë në këtë lloj engjëjsh, të cilët janë obliguar me shkrimin e veprave, na bënë të jemi gjithnjë të kujdesshëm, në mënyrë që të mos biem në ndonjë sherr dhe engjëjt ta regjistrojnë kundër nesh. Kjo, gjithashtu, na bënë të kemi shpresë vazhdimisht dhe nxitje të përsosur për kryerjen e veprave të mira që do t'i regjistrojnë engjëjt.

Ky besim vetvetiu na bënë me dije se, ata të cilët e kundërshtojnë Allahun, janë të paktë, edhe nëse janë shumica e njerëzve. Sepse, edhe nëse i marrim të gjithë njerëzit, ata nuk mund të krahasohen vetëm me engjëjt, e të mos flasim për krijesat tjera, të cilat të gjitha i janë nënshtruar Allahut.

Allahu është i kënaqur vetëm me të nënshtruarit dhe vetëm të këtillët Ai do t'i fusë në Xhenetin e Tij.

### **Kushti i tretë: Besimi në Librat**

Allahu i lartësuar thotë:

“O ju që besoni, besoni në Allahun, në të Dërguarit e Tij, në Librin që ia zbriti të Dërguarit të Tij, dhe në Shkrimet që Ai ua zbriti atyre para jush. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, dhe Ditën e Fundit, ai vërtet ka humbur keqas.”<sup>67</sup>

Besimi në Librat përfshin:

- Besimin në Librat e mëparshëm që Allahu ua shpalli të Dërguarve. Këtu përfshihen ato që veçohen me përmendje në Kuran, si:

✓ Shkrimet e Ibrahimit:

---

<sup>67</sup> en-Nisa, 136.

“Dhe kjo është në Shkrimet e kaluara, në Shkrimet e Ibrahimit e të Musës.”<sup>68</sup>

✓ Zeburi:

“... dhe Dawudid i dhamë Zeburin.”<sup>69</sup>

✓ Tewrati (Dhiata e Vjetër):

“Vërtet, Ne e zbritëm Tewratin (Musës). Në të kishte udhëzim dhe dritë.”<sup>70</sup>

✓ Inxhili (Dhiata e Re):

“Pastaj, Ne dërguam pas tyre të Dërguarit tanë dhe dërguam Isën (Jezusin), birin e Merjemes, dhe i dhamë atij Inxhilin ...”<sup>71</sup>

- Ka dhe shumë Libra tjerë numri dhe emrat e të cilave nuk dihet. Allahu e njofton peygamberin për peygamberët tjerë që ishin mohuar më herët, ndonëse kishin pasur me vete Libra e prova të qarta.

“Nëse ata të refuzojnë (O Muhamed), kështu qenë refuzuar edhe të Dërguarit para teje, të cilët erdhën me Shenja/prova të qarta e me Shkrime si dhe me Librin ndriçues.”<sup>72</sup>

- Besimi se Kurani është Libri i fundit i shpallur nga Allahu

Kurani fisnik është Libri të cilin Allahu i madhëruar ia zbriti prej qiellit të Dërguarit të Tij, Muhamedit صلى الله عليه وسلم. Ai përmban në

<sup>68</sup> el-A'laa, 19-19.

<sup>69</sup> el-Isra, 55.

<sup>70</sup> e-Ma'ide, 44.

<sup>71</sup> el-Hadid, 27.

<sup>72</sup> Al Imran, 184.

vete fjalët e Allahut të cilat kanë për qëllim përmirësimin e krijesave, të mirën e njerëzimit dhe e gjithë botëve. Allahu i madhëruar thotë:

"Është e vërtetë që ky Kuran udhëzon për tek ajo që është më e drejta dhe i përgëzon besimtarët..."<sup>73</sup>

Kurani është qartësim madhështor në të cilën u kulluan Librat e mëparshme, si Tevrati, të cilin Allahu ua zbriti çifutëve, apo Inxhilli, të cilin Allahu ua zbriti të krishterëve. Allahu i madhëruar thotë:

"Ne edhe ty (Muhamed) ta zbritëm Librin në të vërtetën, që është vërtetues i Librave të mëparshme dhe dëshmues për to."<sup>74</sup>

Kurani fisnik është fjalë e Zotit të botëve, por të folurit e Tij nuk është si të folurit e krijesave. Të folurit e Krijuesit ndryshon nga të folurit e krijesave dhe nuk përngjan me të. Allahu i lartësuar thotë:

"Asnjë send nuk është si Ai."<sup>75</sup>

Kurani na thërret për hulumtimin e argumenteve të Allahut të madhëruar, për respektimin dhe nderimin e asaj që ka krijuar Ai, për reflektimin mbi krijimtarinë e Tij, për të ditur atë që e kemi të lejuar a të ndaluar (hallallit dhe haramit), për veprimin e punëve të mira dhe largimin nga punët e këqija. Allahu i madhëruar thotë:

"Ne Kuranin e bëmë të lehtë për mësim, por a ka kush që merr mësim."<sup>76</sup>

---

<sup>73</sup> el-Isra, 9.

<sup>74</sup> el-Maide, 48.

<sup>75</sup> esh-Shura, 11.

<sup>76</sup> el-Fet'h, 17.

Allahu i madhëruar e zbriti Kuranin në qiellin e dunjasë në natën e Kadrit, një natë prej netëve të muajit të begatshëm të Ramazanit. Pas kësaj, e dërgoi engjëllin e Tij të madh, Xhibrilin, e bashkë me të edhe ajetet fisnike nga Kurani deri te i Dërguari jonë Muhamedi صلى الله عليه وسلم, pas çka zbritja e Kuranit vazhdoi për vite me radhë. Allahu i lartësuar thotë:

"Ne e zbritëm atë (Kuranin) në natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dish se çka është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se njëmijë muaj!"<sup>77</sup>

Vërtet, kjo natë e bekuar është më e mirë se njëmijë muaj, ngase ajo është nata e zbritjes së Librit fisnik.

Udhëzim Kuranor përfshin tri ndarje, të cilat përmbajnë gjithë atë që i përmirëson njerëzit në çështjet e kësaj bote dhe në problemet e jetës së tyre.

Ndarja e parë paraqet besimin i cili është i obligim për njerëzit ta njohin dhe të besojnë në të: besimi në Allahun, engjëjt, Librat, të Dërguarit, dhe Ditën e Gjykimit.

Ndarja e dytë paraqet dispozitat e Sheriatit nëpërmjet të cilave njerëzit adhurojnë Zotin e tyre, njohin atë çka i afron te Zoti i tyre dhe largohen nga ajo që i largon nga Ai.

Ndarja e tretë paraqet marrëdhëniet e mira ndërnjerëzore, siç janë përmirësimi dhe pastrimi i shpirtit të besimtarit, në mënyrë që ta përforcojë lidhjen vëllazërore dhe ndihmën reciproke mes njerëzve.

Obligimi ynë ndaj Kuranit është që ta lexojmë atë, t'i studiojmë ajetet e tij, t'i kuptojmë urdhrat e dispozitat e tij, t'i zbatojmë ligjet e urdhrat e tij, të largohemi nga ajo që na ndalon dhe nga e gjithë ajo që e hidhëron Allahun e fuqiplotë.

---

<sup>77</sup> Kadr, 1-3.

Fjala “libër” në arabisht është *kitab* (qitap). Rrënja e fjalës *kitab* është *ketb*, që do të thotë të mbledhësh diçka. Arsyeja përse ne i quajmë librat *kitab* është se ne mbledhim mendimet tonë në një libër. Të Dërguarit pranuan libra pjesë-pjesë në vend të një përmbledhjeje të plotë përnjëherësh. Ata, po ashtu, Librat i pranonin në formë verbale, jo në formë të shkruar. Përjashtimi i vetëm nga kjo ishte Musa (alejhi selam), i cili pranoi Pllaka të shkruara nga vetë Allahu i lartësuar.

Të gjitha Librat janë fjalë të Allahut fuqiplotë, çka tregon se Ai flet.

### **Kushti i katërt: Besimi në të Dërguarit dhe Lajmëtarët (pejgamberët)**

Pasi që Allahu i lartësuar krijoi krijesat, zgjodhi prej njerëzve disa burra për t’ua dorëzuar amanetin e kumtimit të urdhrave të Tij, në mënyrë që t’i informojë njerëzit për atë që Ai kërkon prej tyre.

"Ne nuk dërguam asnjë të Dërguar para teje e të mos i shpallnim atij se nuk ka të denjë për adhurim, përveç Meje; pra, të më adhuroni!"<sup>78</sup>

Qëllimi esencial për të cilin Allahu dërgoi pejgamberët dhe i autorizoi të Dërguarit, është thirrja e njerëzve për të adhuruar Allahun dhe për t’u përqendruar në ligjin dhe programin e Tij.

Kush u përgjigjet pejgamberëve të Allahut dhe të Dërguarve të Tij, është prej të shpëtuarve; kush refuzon fjalët e tyre dhe nuk pranon thirrjet e tyre, është prej të dështuarve.

Allahu i lartësuar e ka obliguar muslimanin që të besojë në të gjithë pejgamberët e Allahut dhe në të Dërguarit e Tij duke mos bërë dallim midis syresh, ngase të gjithë janë të Dërguar nga

---

<sup>78</sup> el-Enbija, 25.



Allahu te krijesat e Tij. Allahu i lartësuar thotë:

" I Dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij e po ashtu dhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, Shpalljeve të Tij, të Dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të Dërguarit e Tij..."<sup>79</sup>

Nëse personi beson në disa peygamberë e nuk beson në disa të tjerë, ai është i mangët në Imanin (besimin) e tij në ta. I këtilli është mosbesimtar. Allahu atë nuk e futë në Xhenet, por e dënon me Zjarrin e Xhehenemit. Allahu na mbrojt prej tij! Allahu i lartësuar thotë:

"S'ka dyshim se, ata që nuk besojnë në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të Dërguarve të Tij dhe thonë: 'Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë,' dhe kështu duan të marrim një rrugë të mesme. Të këtillët janë jobesimtarë të vërtetë..."<sup>80</sup>

Disa prej këtyre peygamberëve dhe lajmëtarëve Allahu i lartësuar i përmend në Kuranin fisnik e disa nuk i përmend. Allahu i lartësuar thotë:

"Dhe më parë (dërguam) të Dërguar për të cilët të treguam dhe të Dërguar për të cilët nuk të treguam ..." <sup>81</sup>

Ata për të cilët Allahu na tregoi në Kuran janë: Ibrahim, Is'haku, Jakubi, Nuhu, Davudi, Sulejmani, Ejubi, Jusufi, Musa, Haruni, Zekerija, Jahja, Isa, Iljasi, Ismaili, Eljesa, Junusi, Luti, Hudi, Salihu, Shuajbi, Idrisi, Dhulkifli dhe Ademi.

Gjithashtu, muslimani obligohet të dijë se nuk ka pasur popull prej popujve të kaluar e të mos i ketë dërguar Allahu një paralajmërues

---

<sup>79</sup> el-Bekare, 285.

<sup>80</sup> en-Nisa, 150-151.

<sup>81</sup> en-Nisa, 164.

i cili e thirri popullin e tij për tek Allahu dhe e drejtoi atë kah e vërteta. Allahu i lartësuar thotë:

"... e nuk pati asnjë nga popujt e të mos ketë kaluar nëpër ta një paralajmërues."<sup>82</sup>

Pejgamberllëku apo Shpallja është dhuratë e shtrenjtë nga Allahu i lartësuar me të cilën Ai i veçon disa prej robërve, të cilët, siç u përmend, janë posedues të vlerave të larta, në mënyrë që të mund të qëndrojnë përballë obligimeve të Shpalljes dhe të jenë shembuj fisnikë që pasohen në çështjet e kësaj bote.

Çdo paralajmërues prej paralajmëruesve që kanë kaluar, si një njeri i krijuar nga Allahu, as nuk posedonte gjithësinë, as nuk kishte në dorë dobinë apo dëmin e ndokujt, as nuk ndikonte në dëshirën apo vullnetin e Allahut, as nuk e dinte të fshehtë, përveç asaj që ia mësonte Allahu, siç thotë Allahu i lartësuar:

"Thuaj: 'Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, pos çka do Allahu. Sikur ta dija të fshehtë, do të shumoja për vete të dobishmet e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër veçse paralajmërues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.'"<sup>83</sup>

Që të gjithë këta paralajmërues, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi ta, synonin t'i largonin njerëzit nga humbja, t'i nxirrnin nga errësira në dritë, dhe qenë thirrës për të mirën, drejtues e Imamë të përmirësimit. Secili prej tyre vinte pas tjetrit që ta plotësonte thirrjen, derisa Allahu plotësoi fenë e Tij, përmbylli dërgimin e pejgamberëve dhe të Dërguarve të Tij me Vulën dhe zotëriun e tyre, Muhamedin صلى الله عليه وسلم, feja e të cilit është ajka e feve të mëparshme dhe thirrja e tij është thirrje e plotë dhe e përhershme,

---

<sup>82</sup> Fatir, 24.

<sup>83</sup> el-A'raf, 188.

deri në Çastin e fundit (Ditën e Kijametit), siç thotë Allahu i lartësuar:

"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, dhe jam i kënaqur që fe juaja të jetë Islami..."<sup>84</sup>

### **Kushti i pestë: Besimi në Ditën e Fundit**

Besimi në Ditën e Fundit është kusht prej kushteve esenciale të Imanit, është pjesë e rëndësishme e njohjes së Zotit nga ana e robit. E si të mos jetë, kur kjo ia vërteton njeriut vendin ku do të mbarojë kjo ekzistencë me gjithë tokën, njerëzit dhe krejt krijesat tjera.

Dita e Fundit do të fillojë me shkatërrimin e kësaj ekzistence, kur do të vdesë çdo gjallesë, toka të ndërrohet e të marrë pamje tjetër, dhe, gjithashtu, edhe qiejt. Pastaj Allahu do t'i ringjallë të vdekurit nga varrezat. Allahu i lartësuar thotë:

"A mendon njeriu se do të lihet e të mos zihet për gjë (pa kurrfarë përgjegjësie). A nuk ishte ai një pikë ujë që derdhet, pastaj u bë gjak i trashë, e Ai e krijoi dhe i dha formën? Dhe prej tij Ai i bëri dy lloje: mashkullin dhe femrën. A nuk është Ai (Zot) i fuqishëm që ta ngjallë të vdekurin?"<sup>85</sup>

Besimi në Ditën e Fundit është tejet i rëndësishëm. Kjo rëndësi shfaqet me një imazh të qartë, gjatë leximit të ajeteve Kuranore, të cilat u përmendën më parë. Allahu i lartësuar thotë:

"... por, mirësi e vërtetë është që t'i besosh Allahut, Ditës së Gjykimit ..." <sup>86</sup>

Allahu i lartësuar e ndërlihd përmendjen e Ditës së Kijametit me besimin në Te, dhe kjo nuk ndodh për tjetër përpos për shkak të rëndësisë dhe vlerës që ajo ka. Ai i cili e lexon Kuranin fisnik, do të

<sup>84</sup> el-Maide, 3.

<sup>85</sup> el- Kijame, 36-40.

<sup>86</sup> el-Bekare, 177.

shohë në të ajete të shumta të cilat e përmendin atë dhe flasin rreth saj.

Kohën kur do të ndodhë Dita e Fundit e di vetëm Allahu i lartësuar dhe askush tjetër pos Tij. Ai nuk ia ka treguar këtë askujt prej krijesave të Tij, as ndonjë të Dërguari apo engjëlli të afërm. Allahu i lartësuar thotë:

" Vetëm Ai e di për Kijametin."<sup>87</sup>

Pasi që Allahu i lartësuar t'ua rikthejë jetën njerëzve e t'i nxjerrë ata prej varreve të tyre, do t'i tubojë dhe do t'i mbledhë afër Vetes, në mënyrë që çdonjërin prej tyre ta llogarisë për atë që ka vepruar. Edhe toka do të dëshmojë për atë që është bërë mbi sipërfaqen e saj. Allahu i lartësuar thotë:

"Kur të dridhet toka me dridhjen e saj (të fundit), dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendësinë e vet, njeriu do të thotë: 'Çfarë ka (që dridhet)?' Në atë ditë, ajo i tregon informatat e saj, ngase Zoti yt do ta frymëzojë. Në atë ditë, njerëzit do të shfaqen të ndarë në grupe për t'u shpërblyer për veprat e tyre. Kush punoi ndonjë vepër të mirë që peshon sa grimca, do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe që peshon sa grimca, do ta gjejë."<sup>88</sup>

Jo vetëm kaq, por do të dëshmojnë e do të flasin edhe gjuhët, duart, këmbët, lëkurat, derisa personit t'i pamundësohet gënjeshtria apo ikja. Allahu i lartësuar thotë:

"Në ditën kur të dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart dhe këmbët e tyre për atë çfarë bënin. Në atë ditë, Allahu do t'ua plotësojë shpërblimin e merituar, e ata e dinë se Allahu është e Vërteta e qartë."<sup>89</sup>

---

<sup>87</sup> Fussilet, 47.

<sup>88</sup> ez-Zelzele, 1-8.

<sup>89</sup> en-Nur, 24.

Kështu, pra, plotësohet argumenti i Allahut ndaj botëve. E, ai që ka qenë mirëbërës, Xheneti do të jetë vendi i tij; ai që i ka bërë gjynahe Zotit të tij, do të dënohet me Zjarr, e sa përfundim i keq që është ai!

### **Kushti i gjashtë: Besimi në Kader (paracaktim hyjnor)**

Kader do të thotë që Allahu paracaktoi gjithçka që ndodh në univers sipas dijes paraprake që Ai ka dhe sipas asaj çfarë dikton Urtësia e Tij.

Besimi në Kader përfshin katër gjëra:

1. Besimi se Allahu i di të gjitha gjërat në përgjithësi dhe në hollësi, qoftë kjo lidhur me veprimet e Tij, qoftë me veprimet e robërve të Tij.
2. Besimi se Allahu e ka shkruar tërë këtë në Librin e Dekretimeve (*el-Lewh el-Mahfudh*).

Lidhur me këto dy çështje, Allahu fuqiplotë thotë:

“Ta dish se Allahu di për çdo gjë që është në qiej e në tokë. Vërtet, krejt kjo gjendet në Librin (*el-Lewh el-Mehfudh*). Vërtet, kjo është e lehtë për Allahun.”<sup>90</sup>

Pejgamberi ﷺ tha:

“Allahu shkroi dekretimet e krijimit 50 000 vjet para se të krijonte qiejt dhe tokën.”

3. Besimi se çfarëdo që ndodh, ndodh vetëm me vullnetin e Allahut, qoftë kur kjo ka të bëjë me veprimet e Tij, qoftë me veprimet e qenieve të krijuara.

---

<sup>90</sup> el-Haxh, 70.

Sa u përket veprimeve të Tij, Allahu i lartësuar thotë:

“Zoti juaj krijon sipas vullnetit të vet.”<sup>91</sup>

Sa u përket veprimeve të qenieve të krijuara, Ai thotë:

“Po të ishte Allahu i vullnetshëm që kjo të mos bëhej, ata s’do ta vepronin.”<sup>92</sup>

Të gjitha ngjarjet dhe veprimet ndodhin vetëm me vullnetin e Allahut. Për çfarëdo që Allahu ka vullnet të ndodhë, ndodh; për çfarëdo që Ai nuk ka vullnet të ndodhë, nuk ndodh.

4. Besimi se të gjitha gjërat që ndodhin janë krijuar nga Allahu i plotfuqishëm në qenësinë e tyre, në cilësitë e tyre dhe në lëvizjet e tyre.

Allahu i lartësuar thotë:

“Allahu është Krijuesi i të gjitha gjërave dhe Ai është Kujdestari i të gjitha gjërave.”<sup>93</sup>

“Ai krijoi gjithçka dhe e mati atë saktësisht sipas masave që i takojnë.”<sup>94</sup>

Allahu i madhëruar na tregon për atë që peygamberi Ibrahim u tha popullit të tij:

“Kurse Allahu ju krijoi ju dhe atë çfarë ju bëni.”<sup>95</sup>

---

<sup>91</sup> el-Kasas, 68.

<sup>92</sup> el-En’am, 112.

<sup>93</sup> ez-Zumer, 62.

<sup>94</sup> el-Furkan, 2.

<sup>95</sup> es-Saffat, 96.

Nëse personi beson në të gjitha këto gjëra, atëherë ai beson si duhet në paracaktimin hyjnor (Kader).

Besimi në Kader nuk kundërshton idenë se personi ka vullnet të lirë sa u përket veprimeve të cilat ai mund t'i zgjedhë. Ai mund të zgjedhë të bëjë apo të mos i bëjë gjërat të cilat ka mundësi t'i bëjë nga aktet e adhurimit apo gjynahet. Sheriati dhe jeta na tregojnë që njerëzit e kanë këtë mundësi/vullnet.

Sa i përket Sheriatit, Allahu i patëmeta thotë lidhur me vullnetin e Tij:

“Kjo, pa dyshim, është Dita e Vërtetë. Kush të dojë, le të kërkojë një vend (apo mënyrë) për te Zoti i vet (duke iu bindur Atij)”<sup>96</sup>

“Afrojuni arës suaj si të doni.”<sup>97</sup>

Dhe Ai, më i larti, thotë lidhur me mundësinë e njeriut:

“Ruhuni nga Allahu sa të keni mundësi.”<sup>98</sup>

Këto ajete konfirmojnë që njeriu ka vullnet dhe mundësi për të bërë çfarë të dojë dhe të mos bëjë çfarë nuk do.

Sa i përket jetës, gjithkush e di për vete që ka vullnet dhe mundësi për ta bërë atë çfarë do dhe të mos bëjë atë çfarë nuk do. Dhe ai mund të dallojë mes gjërave që ndodhin, kur ai do që ato të ndodhin - si ecja -, dhe mes atyre që ndodhin pa dashur ai - si pasja e etheve. Por, vullneti dhe mundësia e njeriut i nënshtrohen vullnetit dhe dekretit të Allahut, sepse Allahu i lartësuar thotë:

---

<sup>96</sup> en-Nebe, 39.

<sup>97</sup> el-Bekare, 223.

<sup>98</sup> et-Tegabun, 16.

“Për këdo prej jush që do të ecën drejt. Dhe ju s’mund të keni vullnet (për diçka), përveç nëse Allahu është i vullnetshëm (që ju të keni vullnet për atë gjë).”<sup>99</sup>

Por, i tërë universi është nën pushtetin e Allahut fuqplotë dhe kurrë s’mund të ndodhë në pushtetin e Tij pa dijen dhe pa vullnetin e Tij.

---

<sup>99</sup> et-Tekwir, 29.



## XHENETI – SHPËRBLIMI PËR TË QENËT ROB I MIRË

Xheneti është një vend i gjerë e madhështor, të cilin e ka përgatitur Allahu i lartësuar për robërit e Tij, të cilët i nënshtrohen në jetën e kësaj bote dhe i respektojnë urdhrat e Tij. Xheneti është shpërblim për besimin e tyre të sigurtë dhe për punët e tyre të mira. Allahu i lartësuar thotë:

"Dhe ngutuni (me punë të mira) për falje gjynahesh nga Zoti juaj dhe për një Xhenet gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit."<sup>100</sup>

Allahu fuqiptotë e cilëson Xhenetin me begati të përhershme, ku kënaqësia nuk përfundon. Çdo send që është në të, është i pallogaritshëm. Në të ka lumenj të gjithfarëllojshëm. Prej tyre ka që e kanë ujin të mirë e të shijshëm, era dhe shija e të cilëve nuk ndryshojnë. Prej tyre ka që janë prej qumështit të pastër e të mirë. Ka që janë prej verës, e cila është e shijshme për ata që e pinë, jo sikur vera e ndaluar e kësaj bote, e cila e shkatërron mendjen dhe e humb vetëdijen. Në të ka dhe lumenj nga mjalti i kulluar.

Prej mrekullive me të cilat Allahu i lartësuar i furnizon banorët e Xhenetit janë frutat e shijshme, me shije të ndryshme, të cilat i ngjajnë njëra-tjetrës. Banorët e Xhenetit do të mendojnë se ky është ushqimi i njëjtë të cilin e hanin më parë, por Allahu i lartësuar thotë:

"Përgëzoji ata që besuan dhe bënë vepra të mira se do të jenë në Xhenete ku rrjedhin lumenjtë. Sa herë që t'u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata do të thonë: 'Me këtë ushqeheshim edhe më parë.' Ngase u sillet ushqim i ngjashëm (vetëm në formë, por jo

---

<sup>100</sup> Ali Imran, 133.

edhe në shije). Aty do të kenë bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë."<sup>101</sup>

Furnizimin e përgatitur nga Zoti i tyre do t'ua shërbejnë djelmoshat të cilët do t'u përgjigjen kërkesave dhe dëshirave të tyre. Këta djelmosha do të mbartin enë e gota nga ari i pastër, të cilat, nga bukuria dhe përsosuria që kanë, u ngjajnë margaritarëve të derdhur. Allahu i lartësuar thotë:

"Dhe atyre u sillen për shërbim djelmosha që përherë janë të tillë; kur t'i këqyrësh, të duken si margaritarë të shpërndarë."<sup>102</sup>

Nga begatitë e Xhenetit me të cilat Allahu i begatoi robërit e Tij besimtarë dhe i veçoi prej krijesave tjera është veshja. Veshja e banorëve të Xhenetit është nga mëndafshi i hollë dhe i trashë, i zbukuruar me ari të pastër.

Edhe vendbanimet e tyre, gjithashtu, janë të bukura. Renditja e tyre është e mrekullueshme, me dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën, nën të cilat rrjedhin lumenjtë. Allahu i lartësuar thotë:

"Ndërsa për ata të cilët u ruajtën për hir të Zotit të tyre do të ketë dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën, nën të cilat rrjedhin lumenjtë. Premtim i Allahut, dhe Allahu nuk e thyen premtimin."<sup>103</sup>

Gjërat që janë në Xhenet përngjajnë vetëm në emra me gjërat e kësaj bote, ngase në të gjendet ajo që syri nuk ka parë, veshi nuk ka dëgjuar, dhe as që mund ta parafytyrojë mendja e njeriut. Allahu i madhëruar thotë:

---

<sup>101</sup> el-Bekare, 25.

<sup>102</sup> el-Enbija, 19.

<sup>103</sup> ez-Zumer, 20.

"Askush nuk di për atë që mbahet fshehur për ta nga kënaqësia si shpërblim për ata që vepronin."<sup>104</sup>

Në Xhenet nuk ka gjynahe e fjalë të kota. Në të ka vetëm përmendje dhe lavdërim të Allahut të patëmeta. Paqja e Allahut dhe bekimi i engjëjve do të jenë mbi besimtarët e, gjithashtu, edhe besimtarët do ta bekojnë njëri-tjetrin. Allahu i lartësuar thotë:

"... ata do t'i vizitojnë engjëjt duke hyrë në secilën derë. (U thonë): Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin. Sa përfundim i lavdishëm është ky vend!"<sup>105</sup>

Banorët e Xhenetit do të jenë banorë të paqes dhe të sigurisë. Allahu i plotfuqishëm do të nxjerrë prej zemrave të tyre mërzinë dhe urrejtjen ndaj njerëzve; të gjithë do të jenë vëllezër të dashur. Dhe në Xhenet ata as s' do të lodhen, as s' do të sëmuren.

Begatia dhe dhuntia më e madhe të cilën do ta gjejnë besimtarët në Xhenet është se ata do ta shohin Zotin e tyre - i madhëruar qoftë - dhe do ta fitojnë kënaqësinë e Tij. Allahu i madhëruar thotë:

"Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara) që Zotin e tyre e shikojnë."<sup>106</sup>

"... dhe kënaqësi nga Allahu që është mbi të gjitha."<sup>107</sup>

Kjo është nga plotësimi i begative të Allahut ndaj robërve të Tij dhe njëherësh nder e respekt që Ai u bën atyre. Xheneti është i përhershëm dhe, për këtë arsye, edhe banorët e tij do të jenë të përhershëm. Allahu fuqimadh thotë:

---

<sup>104</sup> es-Sexhde, 17.

<sup>105</sup> ez-Zumer, 24.

<sup>106</sup> el-Kijame, 22-23.

<sup>107</sup> et-Tewbe, 72.

"Sa u përket fatmirëve, ata do të jenë në Xhenet përgjithmonë, sa të jenë qiejt e toka, përveç çka do Zoti yt. Shpërblim i pandërprerë."<sup>108</sup>

---

<sup>108</sup> Hud, 108.

## XHEHENEMI – NDËSHKIMI PËR MOSNËNSHTRIM

Ai i cili e kundërshton Allahun e madhëruar, vepron punë të këqija e i lë punët e mira, me siguri që Allahu fuqiplotë do ta ndëshkojë për veprat që i bën dhe do ta fusë në Zjarrin e Xhehenemit. Allahu na faltë ne dhe ju!

Sikurse Xheneti, edhe Xhehenemi ka disa emra: *es-Seir/Zjarri* i ndezur fort; *Ledha/Flakë*; *el-Hawije/Zjarri* me nxehtësi shumë të lartë; *es-Sekar/Zjarri* i cili nuk lë send pa djegur.

Secili prej këtyre emrave dëshmon për ashpërsinë e ndëshkimit. Zoti i plotfuqishëm, gjithashtu, përmend se lëndë djegëse të këtij Zjarri do të jenë njerëzit dhe gurët; Ai thotë:

"O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjet tuaja prej një zjarri lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (Zjarrin) e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër, që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë për çka urdhërohen."<sup>109</sup>

Edhe banorët e Zjarrit do të hanë, do të pinë e do të vishen, por ... Çka do të hanë? Çka do të pinë? Çka do të veshin? Allahu i lartësuar thotë:

"A është më e mirë kjo pritje (me shpërblim prej Allahut), apo pema e Zekkumit? Ne atë e bëmë për zullumqarët. Ajo është një pemë që mbin në fund të Xhehenemit. Frytet e saja janë sikurse koka dreqërisht. Ata do të hanë nga ajo dhe do t'i mbushin barqet. Pas tërë kësaj, atyre do t'u jepet uji i valë për të pirë. Pastaj kthimi i tyre është në Zjarr."<sup>110</sup>

Për pijen e tyre Allahu i lartësuar thotë:

---

<sup>109</sup> et-Tahrim, 6.

<sup>110</sup> es-Safat, 61-68.

"Ne kemi përgatitur për jobesimtarët një Zjarr muret e të cilit i rrethojnë ata. Kur ata të kërkojnë shpëtim, do të ndihmohen me një ujë si katran, që përzhit fytyrat. Sa e shëmtuar është ajo pije dhe sa vend i keq që është ai."<sup>111</sup>

Për veshjen e tyre Allahu i madhëruar thotë:

"... e atyre që nuk besuan do t'u qepen rroba prej Zjarri dhe do t'u hidhet uji i valë mbi kokat e tyre, nga i cili do t'u shkrihet krejt çka kanë në barqet e tyre e edhe lëkurat. Dhe për ta do të ketë grepa të hekurt."<sup>112</sup>

Kështu do të jetë jeta e banorëve të Xhehenemit... Dënim e fatkeqësi. Dëshpërim e ndëshkim. Ata as nuk do të vdesin e të rehatohen e as nuk do të jetojnë jetë të këndshme e të dëfrehen. Allahu i lartësuar thotë:

"E asaj do t'i shmanget ai, që është shumë i keq, i cili do të hyjë në Zjarrin e madh, ku as nuk do të vdesë e as nuk do të jetojë."<sup>113</sup>

Besimtarët e mirë, të cilët i janë nënshtruar Zotit të tyre, i janë përgjigjur urdhrave të Tij dhe janë larguar nga ndalimet dhe qortimet e Tij, nuk do t'i godasë asgjë nga kjo.

Por ...

Ka disa nga besimtarët që falen, agjërojnë ..., por të cilët bien në disa gjynahe, kundërshtojnë disa ndalime dhe i lënë disa obligime ... Vallë, si do të jetë gjendja e tyre? A do të jenë ata në Xhenet, apo në Zjarr? Allahu i plotfuqishëm thotë.

"Në Ditën e Gjykimit, Ne do të vejmë peshoja të drejta e askujt nuk do t'i bëhet e padrejtë. Edhe nëse (vepra) është sa peshoja e

---

<sup>111</sup> el-Kehf, 29.

<sup>112</sup> el-Haxh, 20-22.

<sup>113</sup> el-A'la, 11-13.

një kokrrë të melit, ne do ta sjellim atë. Mjafton që Ne jemi llogaritës."<sup>114</sup>

Allahu i lartësuar është më i Urti i të urtëve, më i drejti i të drejtëve... Ai, i madhëruar qoftë, për ata që do të jenë në këtë gjendje, do të gjykojë ashtu që do të maten veprat të tija të mira si edhe të këqijat për të cilat ai nuk është penduar. Nëse të mirat peshojnë më rëndë, ai do të jetë në Xhenet; nëse gjynahet peshojnë më rëndë, do të hyjë në Zjarr, pastaj aty do të dënohet aq sa ka bërë gjynahe. Pasi që Allahu t'ia plotësojë dënimin në bazë të drejtësisë dhe urtësisë së Tij, ai do të dalë prej aty dhe do të hyjë në Xhenet.

Zjarri i përhershëm nuk do të përfundojë kurrë. Banorët e Zjarrit nuk do t'i godasë vdekja e as nuk do të mbarojnë. Allahu i lartësuar thotë:

"Për sa u përket fatkëqijve, ata do të jenë në zjarr, ku do të dihasin e gërhasin (nga vështirësia në frymëmarrje). Aty do të jenë përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç çka të dojë Zoti yt. Vërtet, Zoti yt punon çfarë të dëshirojë."<sup>115</sup>

Fshehtësia e mbetjes së banorëve të Xhehenemit përgjithmonë në të qëndron te kokëfortësia (këmbëngulja) e tyre në veprimin e gjynaheve, meqenëse Allahu i lartësuar lejoi ata të vepronin atë që zgjodhën. Edhe sikur të jetonin me qindra vite, ata do të mbeteshin në mosbesimin dhe kokëfortësinë e tyre. Allahu i lartësuar thotë:

"Sikur t'i shihje ata kur të mbahen mbi Zjarr e të thonë: 'Ah!, sikur të ktheheshim (në dynja) e të mos i përgënjeshtonim faktet e Zotit tonë e të ishim besimtarë! Jo (s'është ashtu), po atyre u doli në shesh ajo që e mbanin fshehtë më parë, prandaj, edhe sikur të

---

<sup>114</sup> el-Enbija, 47.

<sup>115</sup> Hud, 106-107.

ktheheshin, ata do ta përsëritnin atë që u ishte ndaluar. Pa dyshim, ata janë gënjeshtarë."<sup>116</sup>

---

<sup>116</sup> el-En'am, 27-28.



## NAMAZI DHE PARAPËRGATITJET PËR TË

### ABDESI – PASTRIMI PËR NAMAZ

Adhurimi më i rëndësishëm vepror me të cilin Allahu i obligoi robërit e Tij është namazi. Për kryerjen e namazit ka kushte pa të cilat namazi nuk është i vlefshëm, dhe më i rëndësishmi prej tyre është abdesi. Allahu i lartësuar thotë:

"O ju që besoni, kur doni të ngriteni për të falur namazin, lani fytyrat dhe duart deri në bërryla, fërkoni kokat, e lani këmbët deri mbi nyej."<sup>117</sup>

Pra, ai i cili dëshiron të falet, patjetër duhet të marrë abdes.

Pejgamberi صلى الله عليه وسلم tha:

"Allahu nuk e pranon namazin pa pastërti (pa abdes)."<sup>118</sup>

Para se të mësojmë formën e abdesit, obligohemi të dimë një gjë të rëndësishme, të cilën shpeshherë e kryejmë para abdesit, që është kryerja e nevojës. Për kryerjen e nevojës ka rregulla për të cilat na ka mësuar pejgamberi صلى الله عليه وسلم, prandaj, ai që do të kryejë nevojën, duhet t'u përmbahet këtyre rregullave:

- Të hyjë në nevojtoare me këmbën e majtë duke thënë: *Bismillah, Allahumme inni eudhu bike minel-khubuthi wel-khabaith*/Me emrin e Allahut, o Zoti im kërkoj mbrojtje te Ti nga gjërat e ndyra e të liga (të xhinëve e shejtanëve).
- Të heqë prej vetes gjërat që kanë shenjtëri, si mus'hafi (Kurani) e gjëra të tjera.
- Të ketë kujdes të mos i spërkasë teshat e tij me urinë.

<sup>117</sup> el-Maide, 6.


<sup>118</sup> Përcjell Muslimi.

- Të sigurohet plotësisht se, pas kryerjes së nevojës, të mos mbetet ndonjë pikë urinë në organin e tij.
- Të pastrohet nga ndyrësitat e urinës dhe të nevojës së madhe me ujë, me letër apo me diçka të ngjashme.
- Nëse personi dëshiron të pastrohet me letër, obligohet të sigurohet që në letër të mos ketë të shkruar diçka të shenjtë - ndonjë ajet apo ndonjë hadith -, ngase kjo është e ndaluar. Po ashtu, duhet të largohet nga letra ajo që është e ngjashme me këtë.
- Të sigurohet se urina apo nevoja e madhe janë ndërprerë plotësisht.
- T'i shmanget përdorimit të dorës së djathtë gjatë pastrimit dhe ta përdorë dorën e majtë. Nuk prish punë ta përdorë dorën e djathtë për të derdhur ujë.
- Kur ta kryejë nevojën, të dalë nga nevojtorja me këmbën e djathtë duke thënë: *Gufraneke*/Më fal, o Zot.

Pasi ta kryejë nevojën dhe dëshiron të marrë abdes, le të veprojë kështu:

- Të vendosë me zemër për marrjen e abdesit e jo me gjuhë, meqë peygamberi صلى الله عليه وسلم tha: "Veprat vlerësohen sipas qëllimit."<sup>119</sup>
- Të fillojë abdesin duke e përmendur emrin e Allahut, duke thënë: *Bismilah*.

- Pastaj t'i lajë duart tri herë.




<sup>119</sup> Përcjellin Buhariu dhe Muslimi.

- Pastaj të shpërlajë gojën tri herë.



- Pastaj të fusë ujë në hundë (ta shpërlajë mirë) dhe ta nxjerrë nga hunda duke e bërë këtë një deri në tri herë.



- Pastaj të lajë fytyrën tri herë, duke filluar prej ku dalin flokët e deri në fund të nofullës dhe deri te veshët.



- Pastaj të lajë tri herë dorën prej fillimit të gishtërinjve deri në (mbi) bërryla.



- Pastaj ta fshijë (*mes'h*) kokën prej ku nisin flokët në ballë deri mbrapa ku mbarojnë flokët, pastaj t'i kthejë duart prapë aty ku filloi.



- Pastaj t'i lajë veshët, meqë edhe ata janë pjesë e kokës.



- Në fund, t'i lajë këmbët prej gishtërinjve deri në (mbi) nyell të këmbës.



Kur ta përfundosh këtë, ke përfunduar abdesin tënd.

Gjërat që e prishin abdesin janë:

- Kryerja e nevojës së madhe dhe të vogël.
- Lëshimi i gazrave.
- Fjetja (gjumi i thellë).
- Ngrënia e mishit të devesë.<sup>120</sup>

<sup>120</sup> Pejgamberi ﷺ: "Kush han mish deveje, le të marrë abdes."

Vërejtje: Disa njerëz mendojnë se dalja e gjakut e prish abdesin, por kjo nuk është e vërtetë, sepse nuk ka argument për një gjë të tillë.

Vëlla i dashur musliman, nga kjo që u përmend deri tash mësove si të marrësh abdes dhe cilat janë gjërat që e prishin abdesin. Gjithashtu, mësove rregullat e Sheriatit për kryerjen e nevojës, të cilat na i mësoi i Dërguari ﷺ.

## GUSLI – PASTRIMI I PLOTË I TRUPIT

Gusël është një fjalë arabe, që i referohet pastrimit ritual të tërë trupit, para abdesit, nëse i rrituri e humbë gjendjen e pastërtisë trupore.

Janë gjashtë gjëra që e bëjnë guslin të obligueshëm. Nëse një nga këto ndodh, muslimani duhet të bëjë gusël:

1. Dalja e spermës nga mashkulli ose nga femra, që ndodh ose kur personi është i zgjuar, ose kur është në gjumë. Kur sperma del ndërsa personi është i zgjuar, ai ndjen kënaqësi. Nëse sperma del kur ai është në gjumë (ëndërr erotike), gusli bëhet i obligueshëm në të gjitha rastet, sepse ai s'është i vetëdijshëm dhe mund të mos ndjejë kënaqësi. Pra, nëse personi zgjohet dhe gjen gjurmë të spermës (në teshë), duhet të bëjë gusël. Nëse personi përjeton një ëndërr erotike, por nuk del sperma apo nuk gjen gjurmë sperme, nuk ka nevojë të bëhet gusli.
2. Depërtimi i penisit në vagjinë, edhe nëse nuk ka ejakulim, për shkak të hadithit të përcjellë nga pejgamberi ﷺ:

"Kur burri të zërë vend mes katër pjesëve (duarve dhe këmbëve të gruas së vet) dhe të bëjë marrëdhënie me të, gusli bëhet i obligueshëm."<sup>121</sup>

<sup>121</sup> Shënon Muslim.

Pra, gusli është i nevojshëm kur të përfshihen të dy palët (burri dhe gruaja) dhe vetëm me penetrim, edhe nëse s'ka ejakulim, për shkak të këtij hadithi dhe për shkak se ka konsensus mes dijetarëve lidhur me këtë.

3. Sipas disa dijetarëve, gusli është i nevojshëm, kur një mosbesimtar të bëhet musliman, meqë pejgamberi صلى الله عليه وسلم u tha të bënin gusël disave që u bënë muslimanë. Shumë dijetarë mendojnë që kjo është e rekomandueshme e jo e obligueshme, sepse nuk është përcjellë që pejgamberi t'i ketë thënë ta bënte këtë secilit që bëhej musliman. Kështu, sa për të bashkërenduar dëshmitë, mund të thuhet që kjo është e rekomandueshme.
4. Vdekja. Personi i vdekur duhet të lahet, përveç shehidit (martirit) që vdes në betejë, të cilin s'duhet larë.

#### 5. Menstruacionet dhe

6. *Nifasi* (gjakderdhja e paslindjes), sepse pejgamberi صلى الله عليه وسلم tha:

"Kur t'ju përfundojnë menstruacionet, bëni gusël dhe faluni."

Dhe Allahu i lartësuar thotë:

"Kur të jenë pastruar,"<sup>122</sup> duke iu referuar menstruacioneve.

Pra, gratë duhet të pastrohen duke bërë gusël pasi të përfundojnë menstruacionet e tyre.

Si bëhet gusli?

Gusli mund të bëhet në dy mënyra:

---

<sup>122</sup> el-Bekare, 222.

1. Duke i kryer vetëm pjesët e obligueshme të guslit, dmth që uji t'i përshkojë të gjitha pjesët e trupit, dhe të shpëlahet goja e hunda. Nëse personi bën që uji ta përshkojë tërë trupin në çfarëdo mënyre, atëherë ai heq papastërtinë e madhe dhe e pastron veten si duhet, sepse Allahu i madhëruar thotë:

"Nëse jeni *xhunub* (gjendja pas përjetimit seksual), pastrojeni veten (lajeni tërë trupin)."<sup>123</sup>

2. Mënyra e plotë është të bësh gusël ashtu siç bënte i Dërguari i Allahut ﷺ. Kur ai donte të bënte gusël, për shkak të xhunubllëkut, ai i lante duart, pastaj lante organin gjenital dhe vendin ku kishte mbërrir papastërtia, pastaj merrte abdes të plotë, pastaj lante kokën tri herë me ujë, pastaj lante pjesën tjetër të trupit. Kështu bëhet gusli i plotë.

## TEJEMUMI – PASTRIMI ME DHË

Tejemumi është urdhëruar nga Allahu për rastet kur s'ka ujë apo kur personi s'është në gjendje ta përdorë atë, për shkak të sëmundjes apo arsyeve të ngjashme me këtë. Allahu i lartësuar thotë:

"... Nëse jeni të sëmurë, në udhëtim, apo e kryeni nevojën (fiziologjike) dhe nuk gjeni ujë, bëni tejemum me dhë të pastër dhe fërkoni me të fytyrat dhe duart. Vërtet, Allahu fal shpesh dhe shumë."<sup>124</sup>

Personi që do të bëjë tejemum duhet të veprojë si në vijim:

- Të thotë *Bismilah* me nijet për të bërë tejemum

---

<sup>123</sup> el-Ma'ide, 6.

<sup>124</sup> en-Nisa, 43.


- Pastaj e godet tokën (dheun) me pëllëmbë



- Pastaj fshin/fërkon shpinën e dorës së djathtë me pëllëmbën e dorës së majtë dhe shpinën e dorës së majtë me pëllëmbën e dorës së djathtë



- Pastaj fshin fytyrën me dy duart



## FALJA E NAMAZIT

Namazi konsiderohet obligimi vepror më madhështor me të cilin Allahu i obligoi robërit e Tij. Pejgamberi صلى الله عليه وسلم tha:

"Mes kufrit (mosbesimit) dhe imanit (besimit) është lënia e namazit."

Namazi të cilin jemi të obliguar ta kryejmë ka përgatitje të caktuar, thënie të caktuara dhe lëvizje të caktuara. Allahu i patëmeta thotë:



"Vërtet, namazi është obligim për besimtarët në kohën e caktuar."<sup>125</sup>

Domethënë, Allahu i obligoi robërit e Tij që ta kryejnë namazin në kohë të caktuar. Nuk i lejohet muslimanit që, nga pakujdesia, t'i kalojë koha e namazit nga koha e caktuar. Përmes të Dërguarit të Tij ﷺ, Allahu i lartësuar na i sqaroi kohët e namazit, duke filluar nga namazi i sabahut deri na namazin jacisë.

Ne e dimë se koha e namazit ka hyrë atëherë kur ta dëgjojmë myezinin ta thërrasë ezanin:

*Allahu Ekber, Allahu Ekber, Allahu Ekber, Allahu Ekber  
Esh'hedu en la ilahe il'la-Allah, esh'hedu en la ilahe il'la-Allah  
Esh'hedu enne Muhammeden resulullah, esh'hedu enne  
Muhammeden resulullah Hajja alas-salah, hajja alas-salah  
Hajja alal-felah, hajja alal-felah  
Allahu ekber, Allahu Ekber  
La ilahe il'la-Allah*

(Allahu është më i madhi 4x  
Dëshmoj se nuk ka të denjë për adhurim, përveç Allahut 2x  
Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguar i Allahut 2x  
Eja në namaz 2x  
Eja në shpëtim 2x  
Allahu është më i madhi 2x  
Nuk ka të denjë për adhurim, përveç Allahut).

Me këtë kuptojmë se ka hyrë koha e namazit.

Sa u përket përgatitjeve dhe lëvizjeve gjatë namazit, jemi të obliguar që ato t'i marrim nga Suneti (praktika) i pejgamberit ﷺ, i cili tha:

"Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur!"<sup>126</sup>

<sup>125</sup> en-Nisa, 103.

Prandaj, muslimani i cili i është nënshtruar Zotit të tij, obligohet që namazin ta ketë në pëlqim të plotë me namazin e peygamberit <sup>صلى الله عليه وسلم</sup>, në mënyrë që Zoti i tij të jetë i kënaqur me të dhe ta shpërblejë për punën që bën.

Për të qenë namazi i saktë, duhet të plotësohen kushtet në vijim:

1. Abdesi.

2. Pastërtia e trupit dhe e teshave.

Falësi i namazit është i obliguar të kujdeset për pastërtinë e trupit të vet, në mënyrë që të mos mbetet tek ai ndonjë papastërti. E njëjta gjë vlen edhe për teshat dhe vendin ku ai dëshiron ta kryejë namazin

3. Kthimi kah kibla.

4. Hyrja e kohës.

Falja e namazit nuk është e vlefshme para se të hyjë koha për të, ashtu siç nuk është e vlefshme as falja e namazit jashtë kohës së tij (përveç me ndonjë arsye të pranuar shariatikisht). Allahu i lartësuar thotë:

"Mjerë ata që falen! Ata që janë të pakujdesshëm ndaj namazit të tyre."<sup>127</sup>

Domethënë, ata e lënë namazin pas dore duke e vonuar nga koha e tij pa ndonjë arsye shariatike.

5. Mbulimi i avretit (pjesës së turpshme).

Nuk i lejohet falësit të namazit që të falet krejtësisht i zhveshur apo t'i duket avreti. (Avret për meshkujt është pjesa prej kërthizës e deri në gjunjë, ndërsa për femrat avret është i tërë trupi, përveç duarve dhe fytyrës)

Nëse nuk plotësohet cilido kusht prej kushteve të lartpërmendura apo lihet qëllimisht, namazi i personit është i pavlefshëm. Kurse,

<sup>126</sup> Shënon Buhariu.

<sup>127</sup> el-Maun, 4-5.

nëse e lë ndonjërin nga këto kushte nga harresa, gabimisht apo nga padituria, atëherë atij i falet kjo. Mirëpo, nëse lënia bëhet nga padituria, ai obligohet që ta mësojë e të mos e përsërisë më gabimin.

Kur t'i plotësojë të gjitha këto kushte, duhet të veprojë si në vijim:

- E vendos (e bën nijet) me zemër, pa e shqiptuar me gojë, llojin e namazit dhe numrin e rekateve që do të falë, dmth farz apo sunet.


- Pastaj i ngrit duart deri te veshët dhe thotë:  
*Allahu ekber* (Allahu është më i madhi).



- Pastaj vendos në gjoks dorën e djathtë mbi dorën e majtë dhe fillon namazin me dua (lutje), si për shembull:

*Subhaneke Allahumme we bihamdike we  
tebarekesmuke we teala xhedduke we la ilahe  
gajruke.*

(Qofsh i lavdëruar dhe i falënderuar, o Allah. Qoftë i bekuar emri yt. U lartësoftë madhëria Jote. Nuk ka të denjë për adhurim, përveç Teje).



Pastaj kërkon mbrojtje tek Allahu nga shejtani i mallkuar duke thënë:


*Eudhu bil'lahi mine-shejtanirr-rraxhim*

(Kërkoj shpëtim te Allahu prej dëmit të djallit të mallkuar), pastaj e këndon suren el-Fatiha:

*Bismil'lahi-Rrahmani-Rrahiim  
Elhamdulil-lahi Rabbil-alemiin  
E-Rrahmanirr-Rrahiim  
Maliki jeumid-diin  
Ijjeke na'buduu we ijjeke nesteiin  
Ihdinas-siratal-mustekiim  
Siratal-ledhine en amte alejhim  
Gajril-magdubi alejhim we leddal'liin.*

(Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Bamirësit të përgjithshëm. Sunduesit të Ditën së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëzona (përforcona) për në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre që i begatove me të mira, jo në të atyre që tërhoqën kundër vetes hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten.)

Pas el-Fatihas këndon disa ajete tjera apo ndonjë sure (kaptinë) të shkurtër.



- Pastaj i ngrit duart prapë deri te veshët duke thënë *Allahu ekber* dhe pastaj bie në ruku duke i vendosur duart në gjunjët e tij (si më poshtë)



- Në ruku thotë tri herë:

*Subhane rabbijel-adhiim.*

(I pastër nga të metat është Zoti madhështor).



- Pastaj ngritet nga rukuja duke ngritur duart, drejtohet plotësisht dhe thotë:

*Semi Allahu limen hamideh. Rabbena lekel-hamd.*

(Allahu e dëgjon atë i cili falënderon. Zoti jonë, vetëm Ty të takon falënderimi).



- Pastaj bie në sexhde duke vendosur në tokë së pari duart e pastaj gjunjët. Në tokë duhet të vendosë ballin, hundën, gjunjët, duart, gishtërinjtë e këmbës, dhe të thotë tri herë:



*Subhane rabbijel-a'la.*

(I pastër nga të metat është Zoti i lartësuar).

- Pastaj e ngrit kokën nga sexhdeja e parë duke thënë *Allahu ekber*, i vendos duart mbi kofshët, afër gjunjëve, dhe thotë:

*Rabbifirlii, werhamnii, wehdinii,  
werfa'nii, werzuknii*

(Zoti im, më fal, më mëshiro, më udhëzo, më ngrit në pozitë (në Xhenet), më furnizo). Apo thotë vetëm:




*Rabbifirlii, Rabbifirlii*

(O Zot! Më fal, Më fal).

- Pastaj bie në sexhden e dytë dhe vepron njëjtë sikur në të parën.



- Kur ta kryejë edhe sexhden e dytë, e ngrit kokën dhe, para se të ngritet për në rekatën e dytë, ulet/pushon pak.
- Kur ta kryejë gjithë këtë, muslimani e përfundon një rekat me tri kushtet e tija: qëndrimin në këmbë (*kijamin*), rukunë dhe sexhden.
- Pastaj në rekatën e dytë e përsëritë tërë atë që e bëri në rekatën e parë.



- Kur ta përfundojë këtë, ulet dhe e shtrin dorën e djathtë mbi kofshën e tij duke i mbledhur gishtërinjtë e dorës së djathtë, përveç gishtit të madh, të cilin e drejton kah kibla dhe thotë:

*et-Tehijjatu lil-lahi we-salawatu we tajibatu. Es-Selamu alen-Nebijji we rahmetullahi we berekatuhu. Es-Selamu alejna we ala ibadi-lahi-Salihiin. Esh-hedu en la ilahe il'la-Allahu we esh-hedu enne Muhammeden abduhu we resuluhu.*

(Përshtëndetjet, duatë dhe fjalët e mira qofshin për Allahun. Paqja, shpëtimi, mëshira dhe bekimi qofshin mbi të Dërguarin. Paqja qoftë edhe mbi ne dhe mbi robërit e mirë. Dëshmoj se s'ka të denjë për adhurim, përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij.)



*Allahume sali ala Muhammedin we ala ali Muhammed kema salejte ala Ibrahim we ala ali Ibrahim inneke hamiidun mexhiid. Allahume barik ala Muhammedin we ala ali Muhammed kema barekte ala Ibrahim we ala ali Ibrahim inneke hamiidun mexhiid.*

(O Zot! Mëshiroje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit ashtu siç e ke mëshiruar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je i falënderuar dhe i lavdishëm. O Zot! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit ashtu siç e ke bekuar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je i falënderuar dhe i lavdishëm).

Këto janë Teshehudi dhe salavatet.



- Pastaj e lut Allahun për atë që dëshiron nga të mirat e dunjasë dhe të Ahiretit, duke filluar lutjen e tij me kërkimin shpëtimi te Allahu prej katër gjërave nga të cilat ka kërkuar mbrojtje i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم:

*Allahumme inni eudhubike min adhabi xhehennem we min adhabil-kabri, we min fitnetil-mahja wel-memat, we min sherri fitnetil-Mesihi Dexhhal.*

(O Zot, kërkoi mbrojtje te Ti nga ndëshkimi i Zjarrit dhe nga ndëshkimi i varrit, nga sprovat e jetës dhe të vdekjes, dhe nga sprovat e Dexhallit.)

\* Dexhalli është një njeri i cili do të shfaqet para Ditës së Gjykimit dhe do të ketë mundësi të shumta. Ai do të jetë sprovë për njerëzit, ngase do të pretendojë se është zot. Të gjithë këtë ai do të mundohet ta argumentojë me gjëra mahnitëse për njerëzit, si ringjallja e të vdekurve. Ai i cili i beson (e pason) atij, do të hyjë në Xhehenem përgjithmonë; ai i cili e kundërshton, do të jetë prej besimtarëve. I Dërguari i Zotit صلى الله عليه وسلم kërkonte mbrojtje prej kësaj prove të madhe dhe na mësoi që ta lusim Zotin me këtë lutje.

- Pastaj e kthen kokën në të djathtë (jep selam) duke thënë:

*es-Selamu alejkum we rahmetullah*/Paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi ju.

Pastaj vepron njëjtë edhe në anën e majtë.



Me këtë përfundon namazi, nëse i ka 2 rekate.

- Nëse namazi i ka 3 apo 4 rekate, pas këndimit të teshehudit, ai ngritet për rekatin e tretë (para se të japë selam) duke thënë *Allahu Ekber* dhe duke i ngritur duart deri te veshët, dhe e përsërit gjithë atë që ka bërë më parë: qëndrimin në këmbë, rukunë, sexhden ...
- Kur ta përfundojë rekatin e tretë apo të katërt, ulet dhe e thotë gjithë atë që u përmend për uljen dhe në fund jep selam.

### Disa etiketa të namazit

- ❖ Ai i cili falet është mirë të shikojë në vendin e sexhdes (në tokë) dhe të mos e drejtojë shikimi kah qielli.
- ❖ Të mos lëvizë tepër në namaz.
- ❖ Të kujdeset për namazin me xhemat në xhami, ngase namazi në xhami është për njëzeteshtatë herë më i vlefshëm se ai që kryhet vetëm.
- ❖ Të kujdeset për dhikrin (përmendjen) pas namazit, si të thënë tri herë *Estagfirullah* (më fal, o Zot); pastaj *Allahume entes-Selamu we minkes-selamu tebarekte ja dhel-xhelali wel-ikram*. (O Zoti im, Ti je Shpëtimi dhe vetëm prej teje vjen shpëtimi. I bekuar qofsh, o i Madhëruar e i Nderuar).
- ❖ Nëse falësi falet pas imamit, të mos i kryejë veprime në namaz para imamit, domethënë të mos i paraprijë imamit në namaz.
- ❖ Nëse shton, mungon apo dyshon në namaz; p.sh. nëse dyshon për numrin e rekateve, atëherë e plotëson këtë me atë që kërkohet. P.sh. nëse nuk je i sigurt se a ke falur 3 apo 4 rekate, atëherë, pas përfundimit të duasë (lutjes) në teshehudin (uljen) e fundit, i bën dy sexhde para selamit. Kjo quhet sexhde e harresës.
- ❖ Për t'u kujdesur për namazin duhet të dihet numri i rekateve, ato të cilat janë farz (të obligueshme) dhe ato të cilat janë sunet (të vullnetshme).

Namazi i sabahut (i agimit) ka 2 rekate sunet, pastaj 2 farz.

Namazi i drekës (i mesditës) ka 2 (ose 4) rekate sunet, pastaj 4 rekate farz, pastaj 2 rekate sunet.

Namazi i ikindisë (i pasdites) ka 4 rekate sunet, pastaj 4 rekate farz.

Namazi i akshamit ka 3 rekate farz, pastaj 2 rekate sunet.

Namazi i jacisë (i mbrëmjes) ka 4 rekate farz, pastaj 2 sunet, pastaj 3 witër.

Mes namazit farz, sunet apo witër nuk ka dallim sa i përket formës, përveç nijetit. Dhe, siç kemi përmendur më lart, vendi i nijetit është zemra.

Këto ishin në mënyrë përmbledhëse dispozitat e namazit për të cilat duhet të kujdeset dhe t'i kryejë çdo rob musliman. Njëherësh ai obligohet t'i thërrasë edhe të tjerët për kryerjen e tyre. Nëse ai e kryen këtë, atëherë bëhet rob i mirë i Zotit dhe për këtë Allahu i lartësuar do ta shpërblejë me Xhenet dhe do ta shpëtojë nga Zjarri i Xhehenemit.

### **Namazi për të vdekurin (xhenazen)**

Në namazin i xhenazes thuhet katër tekbiere (*Allahu ekber*).

Pas tekbitit të parë, personi e thotë suren el-Fatiha. Nëse pas saj lexon një sure të shkurtër ose një a dy ajete, është më mirë, bazuar në hadithin e saktë, të përcjellë nga Ibn Abbasi.

Pastaj e thotë tekbinin e dytë dhe dërgon salawat për pejgamberin

ﷺ njësoj si në uljen (teshehudin) e namazit.

Pastaj e thotë tekbinin e tretë dhe thotë:

*Allahume gfirmii hajjina we mejjitina, we shaahidina we gaaibina, we sagiirina we kebiirina, we dhekerina ue unthaana. Allahume men ahjajtehu minna feahjihii alel Islam, we men teuefejtehu feteuffehu alel Iman. Allahumme gfirmlehu werhamhu we a'fihii we-'fu anhu, we erim nuzulehu we wessi mudkhelehu, we gsilhu bil maai weth-thelxhi wel beredi, we nekkhi minel khataja kema juneka theubul ebjedu mined-denes, we ebdilhu daaran hajran mik daarihi we ehlen khajran min ehlihi, we edkhillu elxhennete, we eidhhu min adhabil kabr we adhabin nar, uefsah lehu fi kabrihi we newwir lehu fihii. Allahumme la tehrimma exhruhu we la tedhilna ba'dehu.*

(O Allah, fale të gjallin dhe të vdekurin tonë, atë që është prezent prej nesh dhe atë që mungon, të voglin dhe të madhin tonë, mashkullin dhe femrën tonë. O Allah, kujt t'i japësh jetë prej nesh, jepi jetë me Islam, dhe kë prej nesh e bën të vdesë, bëje të vdesë me Iman. O Allah, fale atë, mëshiroje atë, jepi kënaqësi, fale, nderoje gradën e tij, zgjeroje vendbanimin e tij, laje atë me ujë, borë e akull dhe pastroje atë nga gjynahet ashtu siç pastrohet rroba e bardhë prej njollave. Zëvendësoje shtëpinë e tij me një shtëpi më të mirë dhe me një familje më të mirë se familja e tij. Fute atë në Xhenet dhe mbroje atë nga dënimi i varrit dhe i Zjarrit! Zgjerija varrin e tij dhe ndriçoje atë. O Allah, mos na e ndalo shpërblimin e tij dhe mos na le të humbasim pas tij.)

Pastaj e thotë tekbinin e katërt dhe jep vetëm një selam nga krahu i djathtë.

Është e pëlqyeshme ngritja e duarve në çdo tekbin.

Nëse xhenazja është fëmijë, në vend të kërkimit të faljes për të, themi:

*Allahumme ixh'alhu faratan ue dhekhran li walidejhi, we shefian muxhaaba. Allahumme thekkil bihi mewaziinehuma we e'dhim bihi uxhuurahumae elhikhu bisalihil selsefil mu'minin we xhealhu fi kefaleti Ibrahim alejhi salatu wes-salam we kihi birahmetike adhabel xhehim*

(O Allah! Bëje atë paraprijës e mbështetje dhe rezervim për prindërit e tij; bëje atë ndërmjetës të pranueshëm. O Allah, rëndoji me të peshoret e prindërve të tij, shtoji nëpërmjet tij shpërblimet e tyre, mundësoja t'i arrijë gjeneratat e para të besimtarëve, vendose atë nën kujdesin e Ibrahimit - paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të - dhe mbroje atë me mëshirën tënde nga dënimi i Zjarrit).

I gjithë xhemati që do të falet duhet të qëndrojë pas imamit. Dhe vetëm nëse ndonjëri nuk gjen vend le të qëndrojë në krahun e djathtë të imamit.

## **Kaptina të shkurtra të Kuranit**

Cilado nga kaptinat në vijim mund të recitohet pas sures Fatiha në dy rekatet e para të namazit.

### **- Surja el-Keuther**

*Bismilahir-Rrahmanir-Rrahiim*

*Inne e'atajneekel-keuther*

*Fesal-li lirabike wenhar*

*Inne sheenieke huel-ebter*

Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

1. Ne, vërtet, të dhamë ty shumë të mira.
2. Andaj, ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd.
3. S'ka dyshim që urrejtësi yt është fatkeq.

### **- Surja Ihlas**

*Bismilahir-Rrahmanir-Rrahiim*

*Kul huwAllahu eha*

*Allahu Samed*

*Lem jelid we lem juuled*

*We lem jekul-lehu kufurwen eha*

Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

1. Thuaj: Ai, Allahu është Një.
2. Allahu është Ai, që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për nevojat që ka.
3. Ai as nuk ka lindur kë, as vetë nuk është i lindur.
4. Dhe askush nuk i është i barabartë me Atë.

#### - Surja Felek

*Bismilahir-Rrahmanir-Rrahiim*

*Kul e'uudhu birabbil jelek*

*Min sherri maa khalek*

*We min sherri ghasikin idhe wekab*

*We min sherrin-neffetheti fik ukad*

*We min sherri haasidin idhe hased*

Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

1. Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit.
2. Prej dëmit të çdo krijese që Ai e krijoi.
3. Dhe prej errësirës së natës, kur ngryset plotësisht.
4. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja.
5. Edhe prej dëmit të smirëkeqit, kur sipas smirës vepron.

#### - Surja Nas

*Bismilahir-Rrahmanir-Rrahiim*

*Ku euudhu birabbinnas*

*Meliki nnas*

*Ilahi nnas*

*Min sherril-weswaasil-khannas*

*Eledhi juweswisu fii suduuri nnas*

*Minel-xhinneti we nnas*

Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshirëbërësit.

1. Thuaj: Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve.
2. Sunduesin e njerëzve,

3. Të adhuruarin e njerëzve,
4. Prej të keqes së cytësit që fshihet.
5. I cili bën cytje në zemrat e njerëzve,
6. Qoftë ai (cytësi) nga xhinët, qoftë nga njerëzit.

## REFERENCA

- “Islami i lehtësuar” nga Ali Hasen AbdulHamid
- “Përmbledhje fetwash” nga shejh Salih bin Feuzan.
- “Bazat e Fesë Islame” nga shejh Muhamed ibn Ibrahim el-Tuwejxhri
- “Shpjegim i Bazave të Imanit” nga shejh Ibn Utthejmin
- “Çelësi i derës së lumturisë” nga Ibn el-Kajjim
- “Akidja e Tahawiut” nga Imam et-Tahawi
- “Shpjegim i *Kitabu-Tewhid*” & “Përmbledhje fetwash” nga shejh Ibn Utthejmin
- “Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë” nga shejh Bin Baz
- “Përmbledhje e Fikhut Islamik” nga shejh Salih el-Feuzan
- “Fetwa rreth Shtyllave të Islamit” nga shejh Ibn Utthejmin
- Fetwa të Komisionit të Përhershëm për Studime dhe Fetwa të Arabisë Saudite
- Dhe disa përmbledhje tjera që janë në frymën e mësimeve të sipërpërmendura